



# FLETËNOTIMI MJEDISOR I KOMUNAVE

MARS 2025



Instituti Demokratik i Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e  
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse  
dhe luftës kundër korrupsion përmes  
promovimit të transparencës,  
llogaridhënies dhe integritetit në të  
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2025. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jo- komerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rruga Bajram Kelmendi,  
Nr. 239, 10000, Prishtinë, Kosovë

Tel.: +383 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Bartësit e hulumtimit: Selviye Kurti & Ardian Muçaj

Dizajn: Envinion

Projekti "Promovimi i aktivizmit të gjelbër komunitar në Kosovë" mbështetet nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Demokraci (UNDEF). Realizimi dhe publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e UNDEF. Përmbajtja është përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e donatorit.



# Përmbajtja

06

LISTA E  
SHKURTESAVE

07

HYRJE

09

PËRMBLEDHJE  
EKZEKUTIVE

12

METODOLOGJIA

13

PERFORMANCA  
E KOMUNAVE NË  
PËRMBUSHJEN E  
PREMTIMEVE TË GJELBRA  
Komuna e Prishtinës  
Komuna e Mitrovicës së  
Jugut  
Komuna e Ferizajt  
Komuna e Pejës  
Komuna e Rahovecit  
Komuna e Gjakovës  
Komuna e Lipjanit  
Komuna e Skënderajt  
Komuna e Podujevës  
Komuna e Kamenicës  
Komuna e Kaçanikut

65

AGJENDA E GJELBËR E  
BALLKANIT PERËNDIMOR  
DHE REALITETI LOKAL  
Sa janë të informuara  
komunat me Agjendën e  
Gjelbër?

69

REKOMANDIME



# Lista e shkurtesave

<b>KDI</b>	Instituti Demokratik i Kosovës
<b>AQT</b>	Aleanca Qytetare për Transparencë
<b>UNDEF</b>	Fondi për Demokraci i Kombeve të Bashkuara
<b>RCC</b>	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>EBRD</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>PVAGJ</b>	Plani i Veprimit të Agjendës së Gjellbër
<b>PEI</b>	Plani Ekonomik i Investimeve
<b>MCC</b>	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
<b>BERZH</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>GIZ</b>	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>JAICA</b>	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
<b>APK</b>	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
<b>AMMK</b>	Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
<b>PZHU</b>	Plani Zhvillimor Urban
<b>PZHK</b>	Plani Zhvillimor Komunal

# Hyrje

Kosova vazhdon të përballet me sfida të mëdha mjedisore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve. Ndotja e ajrit mbetet një nga problemet më serioze, ku vendi vazhdon të përballet me nivele alarmante të ndotjes, të shkaktuara kryesisht nga termocentralet me qymyr dhe ngrohja me dru. Nivelet e PM2.5 dhe PM10<sup>1</sup> shpesh tejkalojnë standardet e BE-së dhe OBSH-së, duke ndikuar negativisht në shëndetin publik, veçanërisht te grupet më të cenueshme.<sup>2</sup> Ku si rezultat i ndotjes së lartë Kosova kryeson në listën e vdekjeve të parakohshme me rreth 2,370 vdekje për milion banorë.<sup>3</sup>

Kosova, me pozitën gjeografike që ka dhe për faktin se nuk ka dalje në det vazhdon të kanoset nga rreziqet e përfshirjes së pyjeve në zjarre dhe vërshimeve. Sipas Bankës Botërore, Kosova është e cenueshme ndaj risqeve klimatike, përfshirë zjarret në pyje, vërshimet dhe rrëshqitjet e dherave. Aktualisht, 36.8% e sipërfaqes totale të Kosovës është nën risk mesatar nga zjarret, ndërsa 15.8% është nën risk të lartë nga zjarret.<sup>4</sup>

Një tjetër sfidë e madhe për Kosovën mbetet trajtimi i ujërave të ndotur. Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura, konsiderohet një ndër problemet kyçe në sektorin e ujërave.<sup>5</sup> Poashtu, Kosova është larg standardeve të Bashkimit Evropian, për popullsinë me qasje në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotur, ku "mesatarja arrin në 86%,"<sup>6</sup> ndërsa në Kosovë trajtohen ujërat e ndotura të vetëm 8.15% e popullatës me qasje në kanalizimin publik të menaxhuar nga të gjitha KRU.<sup>7</sup> Kurse këtë vit sipas ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin 2025, Kosova synon të arrijë një përqindje prej 45%.<sup>8</sup> Kjo do të thotë se shumica e ujërave të ndotura në Kosovë ende derdhen në mjedis pa u trajtuar, duke krijuar rreziqe për shëndetin publik dhe ekosistemet natyrore. Në anën tjetër, raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën thekson se vendi është ende në fazat e hershme të zbatimit të Agjendës së Gjellbër, veçanërisht në sektorët e transportit, energjisë dhe mjedisit.<sup>9</sup> Raporti gjithashtu shpërfaqë sfidat në zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave duke thënë që Kosova ka shënuar njëfarë përparimi me miratimin e legjislacionit zbatues për eksportin, importin, tranzitin dhe lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave, si dhe me miratimin e legjislacionit për paketimin e mbeturinave. Këto masa kanë vendosur bazat për përgjigjësinë e zgjeruar të prodhuesve dhe aplikimin e parimit ndotësi paguan.<sup>10</sup> Poashtu është shënuar progres në zvogëlimin e numrit të deponive të paligjshme, nga "747 në vitin 2022 në 373 në vitin 2023."<sup>11</sup>

1 Sipas World Bank, PM2.5 i referohet grimcave me diametër deri në 2.5 mikrometra, ndërsa PM10 përfshin grimca deri në 10 mikrometra. Këto grimca të ngurta dhe pika të lëngëta në ajër mund të shkaktojnë probleme të rënda shëndetësore, veçanërisht për sistemin respirator dhe kardiovaskular. (World Bank, "Air Pollution: Understanding PM2.5 and PM10," [link](#)).

2 Ndotja e ajrit dhe shëndeti i njeriut: Rasti i Ballkanit Perëndimor, UNEP, 2019, [Air-Quality-and-Human-Health-Report\\_Case-of-Western-Balkans\\_preliminary\\_results.pdf](#)

3 Agjencia Evropiane e Mjedisit (European Environment Agency – EEA), Kosovo – Air Pollution Country Fact Sheet 2024, publikuar më 10 dhjetor 2024, modifikuar më 18 dhjetor 2024, e qasshme: [Kosovo – air pollution country fact sheet 2024 | European Environment Agency's home page](#)

4 Banka Botërore, Kosovo Country Climate and Development Report, 2024, e qasshme: [link](#)

5 Agjencioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës, RAPORTI GJENDJA E UJËRAVE NË KOSOVË 2020, e qasshme: [Shqip\\_WEB.pdf](#)

6 ETC/ICM Report 1/2018: Outlook on Water and Climate Change Vulnerability in the Western Balkans. E qasshme: [ETC/ICM Report 1/2018: Outlook on Water and Climate Change Vulnerability in the Western Balkans – Eionet Porta](#)

7 LARRU, NIVELI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA OFRUESIT E LICENCUAR PËRPUTHSHMËRIA ME KUSHTET E LICENCËS 2022, publikuar në vitin 2023, e qasshme: [Raporti per Nivelin e Sherbimeve 2022 \(1\).pdf](#)

8 LIGJI NR. 08/L-332 Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Aneksi i performancës sipas sektorëve të politikave, faqe 8, e qasshme: [ActDetail.aspx https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/-PLmbindarjetbuxhetoreperBuxhetineKosoves2025\\_8TbDn5SX-nY.pdf](#)

9 Komisioni Evropian, Raporti i Kosovës 2023. E qasshme: [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/760aacca-4e88-4667-8792-3ed08cd-d65c3\\_en?filename=SËD\\_2023\\_692%20Kosovo%20report\\_0.pdf](#)

10 Komisioni Evropian, Raporti i Kosovës 2024, faqe 82, e qasshme: [c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en](#)

11 Ibid. faqe 82.

Megjithatë, vendi vuan nga kapacitetet e kufizuara inspektuese, ndërkohë që nevojitet ndryshimi i Ligjit për menaxhimin e mbeturinave dhe Strategjisë së integruar të menaxhimit të mbeturinave, për të përfshirë objektiva për riciklim, si dhe për të miratuar planet ndërkomunale për menaxhimin e mbeturinave.<sup>12</sup>

Këto sfida tregojnë nevojën për një qasje multisektoriale, veprime të shpejta dhe mirë të koordinuara midis nivelit qendror dhe atij lokal për të adresuar problemet mjedisore. Në këtë aspekt, komunat, si institucione primare të vetëqeverisjes lokale kanë një rol kyç në mbrojtjen e mjedisit, pasi janë përgjegjëse për çështje të rëndësishme si trajtimi i mbeturinave, zhvillimi i infrastrukturës së transportit të qëndrueshëm, zhvillimi dhe mbrojtja e hapësirave të gjelbra, zhvillimi i infrastrukturës për menaxhimin e ujërave të ndotur, sidhe menaxhimin e rreziqeve për mbrotje nga zjarret dhe vërshimet.

Ky punim analizon performancën e 11 kryetarëve të komunave të Kosovës në përmbushjen e premtimeve të gjelbra<sup>13</sup> gjatë tre viteve të fundit që nga marrja e mandatit për të qeverisur me komunat e tyre. Duke pasë një pasqyrë më të qartë mbi nivelin e përmbushjes së premtimeve të gjelbra nga komunat, në radhë të parë synohet transparencë dhe llogaridhënie më e lartë publike ndaj qytetarëve. Poashtu rritet kuptueshmëria mbi atë se sa i kanë kontribuar këto zotime dhe sa kanë qenë të bashkërenduara politikat lokale të gjelbra me objektivat e Agjendës së Gjelbër, marrëveshje kjo e dakorduar nga të gjitha qeveritë e rajonit të Ballkanit Perëndimor, si instrument i përafritim me direktivën "Green Deal" të Bashkimit Evropian.

KDI ka bërë matjen e përmbushjes së zotimeve të gjelbra të 11<sup>14</sup> kryetarëve të komunave për periudhën 2021-2024, ndërsa gjetjet e këtij fletënotimi mjedisor kanë rezultuar në rekomandime specifike për të gjithë hisedarët që kanë përgjegjësi në jetësimin e politikave dhe projekteve mjedisore.

<sup>12</sup> Ibid

<sup>13</sup> Premtimet e gjelbra brenda një fushate elektorale politike i referohen zotimeve për zhvillimin e projekteve dhe politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës përmes politikave ekologjike, përbledhje nga: [What do political parties talk about when it comes to climate change? - The Connected Politics Lab](#)

<sup>14</sup> Në këtë dokument, kur përmenden 11 komuna, i referohemi komunave që janë subjekt i monitorimit të premtimeve të gjelbra: Ferizaj, Gjakovë, Kaçanik, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Podujevë, Rahovec dhe Skenderaj. Kurse Komuna e Graçanicës ka qenë pjesë e projektit por nuk është subjekt i monitorimit të premtimeve pasi që nuk ka zhvilluar fushatë elektorale.

# Përmbledhje ekzekutive

Në fushatën elektorale për zgjedhjet lokale të vitit 2021 në Kosovë, kandidatët për kryetarë të komunave paraqitën një sërë zotimesh për projekte mjedisore. Megjithatë, analiza e programeve nga KDI dhe organizatat partnere të Aleancës Qytetare për Transparencë (AQT) në 11 komuna tregon se vetëm një pjesë e vogël e këtyre zotimeve janë zbatuar. Konkretisht, deri në dhjetor 2024, vetëm **27.27%** e premtimeve të gjelbra janë përmbushur, duke reflektuar një mungesë të theksuar të llogaridhënies dhe një qasje anemike ndaj qeverisjes së gjelbër.

Programet zgjedhore të ofruara nga kandidatët për kryetarë, projektet që promovonin mbrojtjen e mjedisit apo shtimin e sipërfaqeve të gjelbra kishin zënë hapësirë të rëndësishme. Përtej idesë që projektet e gjelbra do të ishin në fokus të qeverisjes lokale, përgjithësisht ato nuk arritën të etablohen si projekte të analizuara mirë, si në kuptim të realizimit teknik, kohor, efektit që do të prodhonin apo në kuptim të fizibilitetit financiar. Shumica e premtimeve të gjelbra më shumë ishin konceptuar si ide dhe si formulime të thjeshta deklarative, të llojit "Mirëmbajtja dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbruara" (Bedri Hamza, Mitrovicë), "Ndërtimi i shtigjeve të biçikletave" (Shpejtim Bulliqi, Podujevë), "Ndërtimi i parqeve të bukura dhe mirëmbajtja e tyre" (Smajl Latifi, Rahovec), apo "Hapja dhe ndërtimi i parqeve të reja, duke përfshirë edhe këndet e lojërave për fëmijë" (Imri Ahmeti, Lipjan).


Mungesa e detajeve mbi mënyrën dhe afatet e realizimit të këtyre projekteve, burimet e financimit, nevojat e komunitetit, efektet mjedisore, lokacionet apo sipërfaqet e sakta, mirëmbajtja dhe qëndrueshmëria e projekteve e bënë të vështirë të kuptohet nëse këto premtime janë ndërtuar mbi premisa të realizueshmërisë apo janë thjesht pjesë e fushatës elektorale.

Analizimi i programeve zgjedhore të 11 kandidatëve për kryetarë të komunave ka nxjerrë se nga numri i përgjithshëm i premtimeve 1,816<sup>15</sup> për 38 komuna, në 11 komuna që janë subjekt i kësaj analize, vetëm 154, ose 8.48% e tyre lidhen me mbrojtjen e mjedisit si projekte të gjelbra në përgjithësi.

Kjo grafikë paraqet përqindjen e premtimeve të gjelbra brenda programeve zgjedhore të kryetarëve të 11 komunave për mandatin 2021-2025, duke treguar se sa hapësirë zënë angazhimet mjedisore krahas premtimeve totale në programet e tyre elektorale, ku mesatarja është rreth 20%:

<sup>15</sup> Instituti GAP, letërnjoftimi I komunave, e qasshme: [Letërnjoftimi i Komunave](#)

**Përqindja e Premtimeve të Gjelbra brenda Programeve Zgjedhore të Kryetarëve të Komunave për Mandatin 2021-2025**




Nga gjithsej 154 premtime të gjelbra të analizuara në 11 komuna, natyra e tyre është e larmishme dhe përfshin fusha të ndryshme të qeverisjes së gjelbër. Një pjesë e premtimeve janë fokusuar në zgjerimin e hapësirave të gjelbra, krijimin e parqeve dhe pyllëzimin. Për shembull, Prishtina ka premtuar krijimin e 250 hektarëve hapësira të gjelbra, ndërsa Rahoveci ka planifikuar pyllëzimin e 17 hektarëve. Premtime për hapësira të gjelbra kanë dhënë gjithashtu edhe komunat e Kaçanikut, Gjakovës dhe Kamenicës.

Transporti alternativ ka qenë një tjetër premtim, me projekte si ndërtimi i shtigjeve për biçikleta dhe ecje në Prishtinë, Pejë, Rahovec, Mitrovicë, Podujevë, Kamenicë dhe Skenderaj. Poashtu, Prishtina ka synuar zhvillimin e transportit publik miqësor me mjedisin, duke përfshirë zgjerimin e rrjetit të autobusëve elektrikë. Ndërkohë, Podujeva, Skenderaj dhe Kamenica kanë investuar në ndërtimin e stacioneve të reja të autobusëve.

Një tjetër fushë me premtime ka qenë rritja e efikasitetit energjetik, përmes fasadimit të ndërtesave publike dhe private për kursim të energjisë, si dhe vendosjes së paneleve solare në objekte publike në Rahovec, Prishtinë dhe Kaçanik.

Megjithatë, përkundër diversitetit të premtimeve, analiza tregon se një pjesë e konsiderueshme e projekteve mbeten në fazën fillestare të zbatimit ose janë të fokusuar kryesisht në krijimin e parqeve dhe hapësirave të gjelbra. Ndërkohë, iniciativat më komplekse, si implementimi i programeve të efikasitetit energjetik dhe krijimi i sistemeve të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave, ende përballen me sfida të mëdha në zbatim.

**Sa ka zënë hapësirë qeverisja e gjelbër brenda platformës zgjedhore në komuna**



Duke iu referuar zotimeve ambicioze që ka marrë Kosova në kuadër të Marrëveshjes për Agjendën e Gjelbër dhe Planit të Zbatimit, premtime zgjedhore dhe ofertat politike të kandidatëve për kryetarë të komunave gjatë vitit 2021 në përgjithësi nuk ishin të bashkërenduara me këto zotime.

Duke qenë se këto programe zgjedhore u votuan nga qytetarët, pyetja që shtrohet është: A u përmbushën këto premtime? Dhe, më e rëndësishmja, si po ndikojnë ato në jetën reale të qytetarëve?

Sipas analizës së KDI dhe organizatave partnere pjesë të Aleancës Qytetare për Transparencë - AQT në 11 komuna, fakti që vetëm **27.27%** e premtimeve të gjelbra janë përmbushur, ndërkohë që komunat tanimë janë në vitin e fundit të qeverisjes, tregon për mungesë të theksuar të llogaridhënies në zbatim të premtimeve të gjelbra.

# Metodologjia

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me 11 organizata joqeveritare lokale, pjesë të koalicionit joformal Aleanca Qytetare për Transparencë ka bërë monitorimin dhe vlerësimin e përmbushjes së premtimeve të gjelbra të 11 kryetarëve të komunave, të cilat janë shpalosur për qytetarët në formë të ofertave të shkruara programore zgjedhore gjatë zgjedhjeve lokale për kryetarë të komunave në vitin 2021. Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së komunave ka për synim të nxisë transparencën dhe llogaridhënien institucionale për përmbushjen e politikave apo projekteve të orientuara drejt së gjelbrës.

Monitorimi i premtimeve zgjedhore është realizuar gjatë vitit 2024 dhe është i bazuar në informatat publike të viteve 2021-2024. Monitorimi ka përfunduar më 31 dhjetor 2024, dhe gjetjet e tij pasqyrojnë gjendjen deri në atë datë. Për të vlerësuar performancën e komunave në raport me qeverisjen e gjelbër, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna dhe dokumente publike (buxhetet vjetore të komunave, Kornizat Afatmesme Buxhetore, kontrata publike, raportet e punës, etj). Informatat janë siguruar edhe përmes komunikimeve formale me përfaqësues të institucioneve komunale dhe përmes verifikimit të statusit të realizimit të projekteve në terren, përmes vizitave.

Komunat të cilat janë pjesë e këtij vlerësimi janë Prishtina, Mitrovica e Jugut, Lipjani, Ferizaj, Gjakova, Kaçaniku, Rahoveci, Skenderaj, Podujeva, Kamenica dhe Peja. Rezultatet e vlerësimit të zbatimit të premtimeve, rrjedhimisht projekteve të gjelbra komunale janë kategorizuar në 4 nivele të përmbushjes: *të pafilluara, të filluara, gjysmë të përmbushura dhe të përmbushura plotësisht.*

Monitorimi në secilën komunë është realizuar në bashkëpunim me organizatat lokale partnere: Mundësia në Mitrovicë, POLIS në Lipjan, AvoNet në Ferizaj, Qeliza në Gjakovë, Gjethi në Kaçanik, Qendra për Politika dhe Avokim (QPA) në Prishtinë, OJQ SHL Kosova në Rahovec, Iniciativa Qytetare Skenderaj (IQS) në Skenderaj, Ekovizioni në Podujevë, OJQ Fortesa në Kamenicë dhe Syri i Vizionit në Pejë. Këto organizata kanë kontribuar në mbledhjen dhe verifikimin e informacionit.

Nëpërmjet këtij vlerësimi, KDI synon të forcojë qeverisjen lokale dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e implementimit të politikave të qëndrueshme mjedisore në Kosovë. Vlerësimi shërben për të identifikuar praktikatat e mira dhe për të nxitur përmirësime në zbatimin e politikave të gjelbra.



## PERFORMANCA E KOMUNAVE NË PËRMBUSHJEN E PREMTIMEVE TË GJELBRA


# Komuna e Prishtinës

Premtimet e gjelbra të paraqitura në programin elektorale të kryetarit Përparim Rama në vitin 2021 paraqesin një nismë të rëndësishme për ta transformuar Prishtinën në një qytet më të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin, duke përfshirë iniciativa që synojnë përmirësimin e cilësisë së ajrit, menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave, menaxhimin e ujërave të zeza, rregullimin e transportit alternativ, zgjerimin e zonave të gjelbra dhe aplikimin e energjisë eficiente. Ky program në përgjithësi vlerësohet se është në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve të qeverisjes lokale, pasi shumica e premtimeve, përfshirë fasadimin e ndërtesave, menaxhimin e mbeturinave, zgjerimin e hapësirave të gjelbra, menaxhimin e ujërave të zeza, transportin publik, etj., janë në kompetencën e drejtpërdrejtë të komunave. Megjithatë sfida përpara mbetet nëse projektet e mbetura do të arrijnë të konkretizohen si të finalizuara brenda mandatit qeverisës ashtu siç është premtuar gjatë fushatës elektorale.



Në Komunën e Prishtinës, kryetari aktual Përparim Rama ka pasur një program zgjedhor të shkruar, por i cili nuk është i qasshëm në internet. Nga 206 premtime totale të dhëna gjatë fushatës, 43 kanë qenë të fokusuar në çështje mjedisore, që përbën 20.9% të totalit të premtimeve. Programi zgjedhor përfshin premtime të gjelbra, por nuk ka përlogaritje buxhetore të sakta ose të përafërta për këto projekte në programin zgjedhor. Për sa i përket afateve kohore, në programin zgjedhor poashtu nuk janë vendosur afate të sakta për realizimin e projekteve të gjelbra (si periudhat kohore specifike).

Niveli i përmbushjes së premtimeve të kryetarit varion në fusha të ndryshme duke reflektuar në disa projekte të filluara dhe me një numër të kufizuar të atyre që janë përmbyllur plotësisht, por edhe me disa projekte që ende nuk kanë filluar zbatimin. Ndonëse një pjesë e tyre janë përfshirë në buxhetin e vitit 2025, ka ende projekte që nuk kanë filluar dhe nuk ka ndonjë informatë se kur do të përmbyllen.

Në total, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Prishtinës është si vijon:



## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Prishtinës













Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:







Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
1 Rregullimi i shtretërve të lumenjve, për të siguruar mbrojtje nga ndotjet dhe vërshimet.	Me 02.05.2024 është bërë njoftimi për kontratë për këtë shërbim ndërsa në tetor 2024 ka filluar pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe rrjedhave ujore me qëllim të parandalimit të vërshimeve dhe ruajtjen e mjedisit.	 <b>I filluar</b>
2 Analiza të rregullta të ujit dhe tokës	Komuna ka njoftuar se nuk ka pasur ndonjë zhvillim rreth këtij aktiviteti	 <b>I pafilluar</b>
3 Ndërlidhja e zonës 'Qendër' me lagjet përreth, përmes platformave të gjelbra dhe shtigjeve të transportit alternative.	Janë nënshkruar kontratat për ndërtimin e tri urave të përkohshme, të cilat janë në proces ndërtimi deri në dhjetor 2024. Projekti i detajuar për lidhjen e Pallatit të Rinisë me Grandin është përfunduar dhe është vënë në tenderim në qershor 2024. Gjithashtu, është hartuar projekti për ndërlidhjen e zonës qendrore me lagjen Aktash.	 <b>I filluar</b>
4 Nga Fusha e Pajtitimit, në drejtim të fshatrave Makovc, Llukar dhe Grashticë, do të trajtohet lumi në të gjithë gjatësinë e tij, duke përfshirë kanalizimin, ujësjellësin, shëtitoren përbri dhe kolektorin atmosferik	Rrjeti i kanalizimit fekal në të gjitha këto lokacione është në realizim e sipër. Pas përfundimit të rrjetit të kanalizimit, Komuna planifikon të investojë në rregullimin e shtratit të lumit. Këto projekte janë paraparë edhe në buxhetin e vitit 2025.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
5 Investime në ndarjen e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në qytet.	Në çdo investim të infrastrukturës rrugore në qytet, ndarja e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik tani është obligim që përfshihet në çdo kontratë. Kjo përfshin ndërtimin në rrugën A, rrugën B, unazën e qytetit, lagjen Arbëria, Taslixhën, Mati, Muahxherët dhe Kodër të Trimave. Vlera e investimit arrin në shifrën e 6 milionë euro.	 <b>I përbushur</b>
6 Zgjidhja e problemit të kanalizimit në të gjitha fshatrat e Prishtinës, gjatë dy viteve të para të mandatit	Rrjeti i kanalizimit është përfunduar në Rimanishtë për një distancë prej 12 km, ndërsa në Mramor dhe Grashticë janë ndërtuar mbi 10 km. Investime të tjera janë realizuar në Mramor, Grashticë, Bardhosh dhe Llukar. Ky projekt është paraparë të ketë vijimësi edhe në buxhetin e vitit 2025.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>







Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
7 Brenda dy viteve përfundon rrjeti i kanalizimit për fshatrat Rimanishtë, Bardhosh, Besi, Bernicë, Grashticë, Busi, Slivovë, Kukavicë, Dragoc, Novosellë, Siqevë, Radashëc, Sharban, Koliq, Ballaban, Nishevc, Prapashticë, Dabishevc, Hajkobillë, Gllgovicë dhe Keçekollë	Kontrata për ndërtimin e rrugës Barilevë-Bardhosh-Prishtinë është nënshkruar dhe ndërtimi i mbi 80% të rrugës është përfunduar me asfalt. Për rrugët e tjera nuk janë gjetur ose ofruar informacione.	 <b>I filluar</b>
8 Lansimi i një programi masiv që do të ketë për synim krijimin e 250 hektarëve të hapësirave të gjelbra dhe mbjelljen e 800,000 drunjëve fidanor brenda katër viteve	Në maj 2024, u bë implementimi inovativ i pyllëzimit me dronë për mbjelljen e 3000 drunjëve në kuadër të projektit Green Wings në Kosovë dhe rajon. Gjatë vitit 2022, janë mbjellur rreth 15,000 fidane nëpër kontrata të Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve. Komuna ka njoftuar se për muajin maj 2025, po shqyrtohet programi për mbjellje masive – pyllëzim, dhe po vazhdon krijimi i 250 hektarëve të hapësirave të gjelbra. Po ashtu, është në përfundim implementimi i parkut linear në lagjen e Spitalit, ofruet i hapësirave për socializim dhe aktivitete të ndryshme në një sipërfaqe rreth 1.5 ha.	 <b>I filluar</b>
9 Lidhja e zonave të gjelbra përmes krijimit të korridoreve të gjelbra, të cilët do t'u mundësojnë qytetarëve lëvizje nga një pikë e qytetit në tjetrën	Deri në qershor 2024, janë krijuar korridore të gjelbra në Rr. "Eqrem Qabej" në fazën e parë të punimeve. Janë rigjeneruar rreth-rrrotullimet në hyrjet e Prishtinës, Rrethi i Flamurit të Kosovës dhe Rrethi i Flamurit të Shqipërisë. Hapësira tek Stacioni i autobusëve dhe ish objekti Gërmia janë plotësisht regjeneruar. Po ashtu, janë rikrijuar hapësira gjelbëruese në sheshet Zahir Pajaziti dhe Nëna Terezë. Ishujt në Bulevardin Dëshmorët e Kombit në Ulpianë janë revitalizuar plotësisht. Gjithashtu, është rivitalizuar hapësira gjelbëruese në Parkun Linear dhe në ishujt e rrugës, si dhe rreth rrugës Xhevdet Doda që lidh me lagjen Lakrishtë.	 <b>I përbushur</b>
10 Krijimi i shiritit të gjelbër në çdo lagje, i cili do të përbëhet nga bimë të kultivuara	Në bashkëpunim me Yarl Komuna e Prishtinës ka realizuar mbjelljen sezonale në fermat urbane në lagjen Ulpiana tek KultPlus. Ky aktivitet ka për qëllim të përfshijë qytetarët në hapësirat publike, duke vazhduar traditën dhe qëllimin e fermave urbane për të përmirësuar jetën komunitare dhe të ndikojë në vetëdijësimin për qytetarinë aktive dhe të mirën e përbashkët.	 <b>I filluar</b>
11 Ofrimi i lehtësirave tatimore për kompanitë që rrisin numrin e automjeteve "miqësore/ elektrike" ndaj mjedisit		 <b>Nuk ka filluar</b>





Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
12 Lansimi i një programi urgjent për eliminimin e azbestit, nga kulmet e ndërtesave të shumta dhe mundësimi i kulmeve solare për energji solare.	Ka përfunduar studimi i fizibilitetit për identifikimin e azbestit në Kryeqytet. Në janar të vitit 2024, Komuna e Prishtinës prezantoi projektin "Prishtina pa azbest".	 <b>I filluar</b>
13 Lansimi i projektit për një fabrikë të riciklimit të mbeturinave inerte dhe organike.	Deri në dhjetor 2024 është përcaktuar vetëm lokacioni prej 5 hektarëve për ndërtimin e një fabrike të riciklimit të mbeturinave inerte dhe organike dhe komuna ka njoftuar se është në pritje të vendimit prej qeverisë për aprovimin e lokacionit.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
14 Rigjenerimi i rrjetit të grumbullimit të mbeturinave. Ndarja e qytetit në pesë zona për menaxhim të mbeturinave	Ndarja zonale për menaxhim të mbeturinave ka përfunduar. Zona 1 – Lagjet: Tophane, Lakrishtë, Qendër, Pejton, Dardani dhe Ulpianë; Zona 2 – Lagjet: Arbëria dhe Kodra e Trimave; Zona 3 – Lagjet: Kolovicë, Taslixhe, Sofali, Velani, Muhaxherët, Aktash dhe pjesërisht lagjet Mati dhe Kodra e Diellit; Zona 4 – Fshatrat Hajvali dhe Zllatar, Lagjet Prishtina e re dhe lagja e Spitalit, si dhe pjesërisht lagjet Mati dhe Kodra e Diellit; Zona 5 – Fshati Shkabaj, Zona Industriale si dhe Lagjet Qëndresa dhe Kalabria. Rajoni është pajisur me kontejnerë të rinj, është rritur numri i makinave bartëse të mbeturinave dhe është realizuar sanimi i gjendjes në terren.	 <b>I përbushur</b>
15 Caktimi i lokacionit për pikën grumbulluese të mbeturinave të vëllimshme (orendi, tavolina, karrige, televizor dhe pajisje të tjera të amvisërisë).	Është shpallur një tender për zgjedhjen e ofertës ekonomike për grumbullimin e mbetjeve inerte dhe të vëllimshme si dhe janë përcaktuar 5 lokacionet për këtë proces.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
16 Promovimi i biçikletave dhe mjeteve të tjera alternative të transportit	Projekti është duke u implementuar; janë vendosur stacionet me biçikleta në 10 lokacione. Poashtu përmes aktiviteteve të ndryshme komuna promovon përdorimin e mjeteve alternative të transportit.	 <b>I përbushur</b>

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
17 Fasadimi i ndërtesave	Ka përfunduar fasadimi dhe rregullimi gjeneral i ndërtesave në lagjen "Ulpiana" të njohura si katër soliterët. Komuna ka njoftuar se parasheh në vazhdimësi të intervenojë në fasadimin e ndërtesave me qëllim të ngritjes së performancës energjetike të tyre. Poashtu, ka filluar procedura për tenderim (qershor 2024) për fasadimin e një pjese të ndërtesave të vjetra si fazë e parë në lagjen "Dardania", "Ulpiana", rrugët "Agim Ramadani" si dhe në rrugët "UÇK" dhe "Luan Haradinaj".	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
18 Krijimi i oazave natyrale në pika të ndryshme të qytetit me qëllim të rigjenerimit të florës dhe faunës.	Gjatë vitit 2024, në qytet janë krijuar dhe rigjeneruar disa oaza të gjelbra (kryesisht sezonale) në zona të ndryshme të qytetit si në: Aktash, Bregu i Diellit, Mat, përgjatë rrugëve "Agim Ramadani", "Muharrem Fejza", "Sylejman Vokshi", "Tirana", në Tulltore, në Parkun "Adem Demaci", Parkun mbi sallën 1 Tetori, në oborrin e Fakultetit të Historisë, lagjën Qafa (rruga UÇK). Janë përfunduar edhe xhepi urban në rr. "Zekerija Cana", poashtu në "Kodrën e Trimave" është rregulluar një hapësirë urbane dhe afer statiumit "Fadil Vokrri" përgjatë rrugës në afërsi të rrethrotullimit.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
19 Mirëmbajtja e rrugëve do të decentralizohet në katër zona.	Përmes tenderimit të punëkryesëve për mirëmbajtjen verore dhe dimërore, janë angazhuar 10 operatorë ekonomik për zonat urbane dhe rurale në kontratën verore, dhe 14 operatorë ekonomik në kontratën dimërore. Mbikëqyrja e kontratës bëhet përmes 4 komisioneve.	 <b>I përbushur</b>
20 Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore.	Nëpërmjet projektit nga Termokos dhe KFË është bërë zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore në lagjet si (Muharrem Fejza, Arbëria, Qendër të Parku i qytetit dhe qendër të rruga Galibardi, rruga Agim Ramadani); në lagjën "Muharrem Fejza" për furnizim të 141 objekteve, kryesisht për banim kolektiv dhe të SHMU "Pavarësia"; Ulpiana- 23 objekte; Dardani-13 objekte; Qender-49 objekte; Arberia- 23 objekte. Janë instaluar 182 nënstacione të reja në Mati-1, 106 prej tyre janë funksionalizuar.	 <b>I përbushur</b>
21 Shpeshtimi i linjave të autobusëve nga qendra drejt fshatrave dhe anasjelltas.	Linja e re e autobusit për fshatin Glllogovicë, Dabishevë dhe Hajkobillë është implementuar.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
22 Krijimi i korridoreve të gjelbra të cilat i lidhin fshatrat me zonat e gjelbra të qytetit.		 Nuk ka filluar
23 Hapja e tualeteve publike. Këto tualete do të kenë një hapësirë të qasshme, me drita, ujë dhe do të mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme.	Ndërtimi i tualeteve publike në qytet- "Qendra", "Tophane", "Dodona", "Bregu i Diellit", "Ulpiana", "Dardania", "Lakërishta, "Aktashi" është paraparë në buxhetin e vitit 2024. Përveç ndarjes buxhetore ende nuk ka ndonjë zhvillim drejt realizimit të tyre.	 I filluar
24 Krijimi i planit pesë vjeçar rregullativ për masat e energjisë eficiente.	Komuna ka njoftuar se është në fazën përfundimtare të hartimit të planit komunal për energji dhe klimë. Në kuadër të përpilimit të planit 5-vjeçar me projektin e EBRD, janë duke i identifikuar të gjitha objektet publike për të përmirësuar efikasitetin e energjisë.	 I filluar
25 Riparimi i ndërtesave publike për të siguruar përdorim të energjisë eficiente, në objektet e shkollave filllore dhe të mesme, qendra shëndetësore, çerdhe, administratë publike, e në ndërtesa publike të kulturës.	Në dhjetor të vitit 2023, Komuna e Prishtinës nënshkroi një marrëveshje me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për të përmirësuar eficiencën e energjisë në 47 ndërtesa publike. Ky projekt, me një vlerë totale prej 6 milionë euro, përfshin zëvendësimin e sistemeve të ngrohjes, dritareve dhe dritareve, si dhe izolimin termik të kopshteve për fëmijë, shkollave dhe qendrave të kujdesit shëndetësor primar  Ne vitin 2024 është zhvilluar procedura e tenderimit për fasadimin e ndërtesave publike në Bllokun 1, duke përfshirë izolimin termik.	 I filluar
26 Zëvendësimi i llambave joeficiente me ndriçuesit me teknologji LED në sistemin e ndriçimit publik dhe në ndërtesa publike.	Me projektin e mirëmbajtjes së ndriçimit publik është duke u bërë zëvendësimi i poçave, ku deri më tani ndriçimi publik është i mbuluar me teknologji LED deri në 90% të rrugëve sipas përgjigjes zyrtare të Komunës së Prishtinës.	 I përbushur
27 Lëshimi i lejeve të ndërtimit bazuar edhe në kriteret që do të vendosen për objekte që u përmbahen kushteve të eficiencës së energjisë.		 Nuk ka filluar

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
28 Së paku 20-25% e kërkesës për ngrohje të ujit në ndërtesa publike do të mbulohet nga energjia e ripërtërishme.	Termokos, ka filluar hartimin e koncept dokumentit i cili do të identifikojë nevojat reale të konsumatorëve për ujin sanitar dhe përmes këtij dokumenti do të analizohet potenciali aktual i Termokos dhe aftësia e ngrohtores që të furnizojë konsumatorët e saj me ujë sanitar, gjatë sezonit të dimrit.	 I filluar
29 Përgatitja e projekt propozimit për instalimin e paneleve solare në stacionet e autobusit (pikat pritëse në qytet). Energjia e prodhuar nga sistemet solare, do të shërbejë për ndriçimin e këtyre pikave, si dhe do të shërbejë si pikë për mbushjen e telefonave gjatë kohës së pritjes.	Projekti "Solar Parking Prishtina" u përfundua në mars 2024, duke kontribuar në realizimin e këtij premtimi. Megjithatë, Komuna ende është në proces të plotësimit të të gjitha angazhimeve të premtuara.	 Gjysmë i përbushur
30 Instalimi i matësit të energjisë termike, duke ndikuar në shfrytëzim më racional të energjisë termike.	Projekti "Prishtina HeatSave" që nga maji 2022 ka nisur instalimin e matësve të energjisë termike në sistemin e ngrohjes së "Termokos", duke kaluar nga faturimi sipas sipërfaqes në faturim bazuar në konsumin real. Deri në mars 2023, rreth 60-70% e projektit ishte realizuar, duke përfshirë mbi 20,000 konsumatorë. Ky projekt, financuar nga MCC me 11 milionë dollarë, synon shfrytëzimin më racional të energjisë dhe uljen e kostove për konsumatorët.	 I përbushur
31 Ndërtimi i infrastrukturës për dyfishim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit transmetues të kogjenerimit nga 140 MWt – 280 MWt.	Aktualisht, projekti është në fazën e studimit paraprak, i cili do t'i hapë rrugë realizimit të tij.	 I filluar
32 Inicimi i projektit për furnizim me energji termike përmes energjisë diellore.	Më 11 dhjetor 2023, NP "Termokos" dhe Ministria e Financave nënshkruan tri marrëveshje për realizimin e projektit "Solar4Kosovo". Në dhjetor 2022, Qeveria ndau një parcelë prej 25 hektarësh për ndërtimin e impiantit solar, ndërsa në tetor 2022 u përgatit Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit. Aktualisht, projekti është në fazën e përgatitjes teknike dhe pritet të nisë ndërtimi në vitin 2025, me përfundim brenda dy viteve.	 I filluar
33 Përgatitja e infrastrukturës në qytet për makina elektrike.	Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar infrastrukturën për automjetet elektrike. Më 23 korrik 2021, u inaugurua stacioni i parë për mbushjen e makinave elektrike. Në mars 2024, në parkingun e Parkut të Gërmisë, u përfundua projekti "Parkingu Solar Prishtina", i cili përfshin një stacion për karikimin e automjeteve elektrike.	 I filluar

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
34 Vendosija e sensorëve të ndryshëm për të identifikuar ndotësit e ajrit.	Në sektorin e gastronomisë, janë vendosur sensorë për matjen e nivelit të zhurmës dhe decibelëve të lejuar. Për sensorët e ambientit, aktualisht nuk ka të dhëna konkrete. Ndërsa për sensorët e rrjedhjes së ujit, ende nuk ka filluar implementimi.	 <b>I filluar</b>
35 Ndërtimi i Kopshtit Botanik.		 <b>Nuk ka filluar</b>
36 Ofrimi i shërbimit të transportit publik 24 orë në ditë në linjat urbane.	Linjat 1A, 4, 3, 1, është zgjatur orari i operimit deri në orën 24:00. Komuna ka njoftuar se ka paraparë që me projektin e ri-organizimit dhe shtimit të linjave të reja, në koordinim me BERZH-in do të implementohet formati i transportit publik 24 orë në linjat urbane gjat vitit 2025.	 <b>I filluar</b>
37 Ndërtimi i së paku dy impianteve të reja për trajtimin e ujërave të zeza.		 <b>I pafilluar</b>
38 Ripërtëritja e flotës së autobusëve, duke përfshirë edhe operatorët privatë me zero përqind ndotje të ambientit, klimatizim, dhe hyrje/dalje me platformë lëvizëse për nënat dhe personat me karroca.	Faza e prokurimit me BERZH për 30 autobusë të Trafikut Urban është në procesin e shpalljes. Ripërtëritja e flotës së operatorëve të tjerë private fillon nga janari 2025 deri në fund të korrikut 2025 sipas përgjigjes zyrtare të komunës.	 <b>I filluar</b>
39 Stimulimi i përdorimit të transportit publik, përmes krijimit të hapësirave për parking të veturave në hyrje të qytetit, ku çdo qytetar/e me biletën e parkingut, mund ta shfrytëzojë transportin publik.	Projekti "Park and Ride" i Komunës së Prishtinës, i planifikuar të nisë në shtator 2023 te fusha e "Ramiz Sadikut", synon të lehtësojë trafikun urban duke ofruar hapësira parkimi në hyrje të qytetit dhe përdorimin e transportit publik me të njëjtën biletë. Deri në dhjetor 2024, nuk ka informacione mbi zbatimin ose përfundimin e tij. Ky model është përfshirë në Rregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të komunës së Prishtinës të miratuar në dhjetor 2023.	 <b>I filluar</b>

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Përparim Rama (PRISHTINË)	Burimi	Vlerësimi
40 Hapja e shtigjeve të reja për ecje dhe biçikleta në Bërnice të Epërme dhe në fshatrat e Gollakut.	Në buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2023, është paraparë një investim prej 200,000 euro për hapjen e shtigjeve të reja për ecje dhe biçikleta. Megjithatë, nga të dhënat e disponueshme publike, nuk ka informacione specifike që tregojnë se këto fonde janë dedikuar për Bërnicën e Epërme dhe fshatrat e Gollakut.	 <b>I filluar</b>
41 Kompletimi dhe miratimi i hartës zonale të Prishtinës.	Harta Zonale e Komunës së Prishtinës, ka qenë në proces hartimi që nga viti 2018. Megjithëse parashikohej të përfundonte brenda 18 muajsh, deri në janar 2025, ende nuk është miratuar. Në vitin 2023, Plani Zhvillimor Komunal ishte në fazën e dorëzimit për diskutim publik, por miratimi i Hartës Zonale mbetet i papërfunduar.	 <b>I filluar</b>
42 Kompletimi dhe miratimi i planeve të hollësishme rregulluese.	1. Plani i hollësishëm Kalabria është aprovuar nga Kuvendi Komunal dhe gjendet në Ministrinë gjegjëse për aprovim. 2. Plani Arbëria blloku D-2 është aprovuar 3. Plani Mati është e procedurë.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
43 Përsheptimi i procesit të legalizimeve të ndërtimeve pa leje në Prishtinë.	Komuna e Prishtinës ka njoftuar se procedurat e legalizimit kanë pasur ngecje për shkak të mos lejimit të ministrisë përgjegjëse për t'i vazhduar kontratat për shërbime të veçanta të stafit të angazhuar në legalizim. Prej muajit maj 2024 është rifilluar me stafin e ri të angazhuar.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>




# Komuna e Mitrovicës së Jugut

Programi elektorral i Komunës së Mitrovicës, nën udhëheqjen e kryetarit Bedri Hamza, ka paraqitur disa premtime të gjelbra që synojnë përmirësimin e kushteve mjedisore dhe zhvillimin e hapësirave publike, kryesisht përmes investimeve në infrastrukturën e lumenjve, menaxhimin e mbeturinave dhe shtimin e gjelbërimit. Nga një perspektivë e gjelbër, këto synime janë tejet të rëndësishme për qytetarët dhe ruajtjen e biodiversitetit, duke ofruar një pikënisje pozitive për zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Megjithatë, analiza tregon se jo të gjitha premtimet përputhen plotësisht me kompetencat e nivelit lokal - si pastrimi i mbeturinave industriale që për rrjedhojë krijojnë pritshtëri që komuna mund të mos i përmbushë plotësisht. Në anën tjetër, ndërsa vetëm një numër i vogël projektesh të premtuara ka përfunduar me sukses ose ka arritur një fazë të avancuar, shumica e premtimeve mbeten ende në fazën fillestare.



Në Komunën e Mitrovicës së Jugut, kryetari ka pasur një program zgjedhor të shkruar gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2021, por ai nuk është i qasshëm në internet. Nga gjithsej 123 premtime elektorale të dhëna gjatë fushatës, 10 premtime janë të fokusuar në çështje mjedisore, duke përbërë 8.13% të totalit të premtimeve. Programi zgjedhor nuk përfshin përllogaritje të sakta buxhetore për projektet e gjelbra. Buxheti i saktë i dedikuar gjatë këtij mandati për projekte të gjelbra nuk dihet pasi që institucionet komunale nuk i janë përgjigjur kërkesës për qasje në këtë informacion rreth kësaj çështjeje mirëpo nga informatat e marra nga uebfaqja e komunës është nxjerrë si informacion se për vitin 2024 janë dedikuar 246,011,70 euro. Në programin zgjedhor të kryetarit nuk janë përcaktuar afate kohore të sakta për realizimin e projekteve të gjelbra. Gjithashtu, nuk është shqyrtuar kapaciteti ekzistues njerëzor i komunës gjatë propozimit të këtyre projekteve brenda programit.

Nga analiza e implementimit të premtimeve të gjelbra se shumica e projekteve janë vetëm të filluara, ndërkohë që një pjesë e vogël ka përparuar ose është finalizuar. Kjo situatë thekson nevojën për një përkushtim më të lartë nga strukturat komunale në drejtim të përmbushjes së projekteve të premtuara në mënyrë që angazhimet për aplikimin e praktikave të gjelbra të konkretizohen në praktikë.







**Në total, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Mitrovicës është si vijon:**







**Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Mitrovicës**



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Bedri Hamza)	Statusi i premtimit	Vlerësimi për përmbushjen e premtimit
1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.	Më 12 dhjetor 2021, është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në qytetin e Mitrovicës, me një vlerë prej 4.6 milionë euro. Kjo marrëveshje është ratifikuar më 06.04.2022 gjithashtu edhe në Kuvendin e Kosovës. Ky projekt udhëhiqet nga qeveria dhe ujësjellësi.	 <b>I filluar</b>
2 Instalimi i pajisjeve matëse për cilësinë e ajrit.	Komuna ka siguruar fondet për vitin 2024 për këtë projekt, por sipas përgjigjes zyrtare ka pasur probleme me procedurat e tenderimit, të cilat kanë shkaktuar vonesa në implementim. Çështja ka kaluar përsëri në procedurat e tenderimit.	 <b>I filluar</b>
3 Pastrimi i mbeturinave industriale në Parkun Industrial "Trepça" (ish – Fafosi).	Ky projekt është përgjegjësi e qeverisë dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), dhe është duke mos qenë në kompetenca të nivelit lokal.	 <b>Nuk ka filluar</b>
4 Menaxhimi i integruar i mbeturinave.	Në vitin 2022, është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërkomunal ndërmjet tri komunave (Mitrovicë e Jugut, Vushtrri dhe Skenderaj) për menaxhimin e integruar të mbeturinave. Ky memorandum është mbështetur nga GIZ-i gjerman, por implementimi i tij në terren deri në dhjetor 2024 nuk ka filluar të zbatohet.	 <b>I filluar</b>
5 Mirëmbajtja dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara.	Nga janari deri në qershor 2022, komuna ka filluar mbjelljen e luleve në hapësirat publike të qytetit. Po ashtu, në liqenin akumulues janë mbjellë 100 fidane. Në fshatin Kaçandoll të Shalës së Bajgores janë mbjellë 10,000 fidane, ndërsa në disa zona të qytetit janë mbjellë drunj dekorativë dhe janë vendosur rrethoja për mbrojtjen e hapësirave të gjelbëruara. Komuna ka njoftuar se mbjellja do të jetë një proces i vazhdueshëm.	 <b>Gjysmë i përmbushur</b>
6 Rregullimi i shtratit të lumit Ibër nga kolegji IBCM – deri te ura në Suhodoll – ndërtimi i shëtitores.	Në vitin 2023, u nënshkrua kontrata me operatorin ekonomik për rregullimin e shtratit të lumit Ibër. Aktualisht, ka filluar implementimi i lotit të dytë, që përfshin segmentin nga liqeni deri te ura e Ibrit, ndërsa pritet të nisë edhe loti i tretë në tremujorin e parë të vitit 2025.	 <b>Gjysmë i përmbushur</b>

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Bedri Hamza)	Statusi i premtimit	Vlerësimi për përmbushjen e premtimit
7 Ndërtimi i hapësirave rekreativo-sportive përgjatë lumit Ibër nga Liqeni – Kushtovë, nga të dyja anët e lumit	Është buxhetuar për vitin 2025.	 <b>I filluar</b>
8 Rregullimi i shtratit të lumit Lushta (Bair-Lushtë) – shëtitore	Të gjitha punimet e parapara sipas kontratës janë përmbyllur me sukses në janar 2024.	 <b>I përmbushur</b>
9 Rregullimi i shtratit të lumit Sitnica–PIM parku industrial–Tuneli Bair-shëtitore	Është buxhetuar për vitin 2025.	 <b>I filluar</b>
10 Rregullimi i shtratit të lumit Trepça – shëtitore	Është buxhetuar për vitin 2025.	 <b>I filluar</b>


# Komuna e Ferizajt

Projektet e prezantuara në programin elektorale të Agim Aliut për Komunën e Ferizajt përfaqësojnë iniciativë për përmirësimin e mjedisit në këtë komunë. Ndërhyrjet si pastrimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve, zgjerimi i parqeve dhe rritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave janë të nevojshme për një qytet që po përballon me urbanizim të shpejtë dhe sfida të lidhura me mbingarkesën urbane. Nga monitorimi del se shumica e premtimeve janë realizuar mirëpo është e rëndësishme që nismat e mbetura të shoqërohen me hapa të tjerë konkretë në raport me krijimin e hapësirave të gjelbra, zgjidhjet më të avancuara për menaxhimin e ndotjes dhe zhvillimin e qëndrueshëm infrastrukturës urbane.



Kryetari i Komunës së Ferizajt ka publikuar një program zgjedhor të shkruar, i cili është i qasshëm në internet. Nga 69 premtimet e dhëna gjatë fushatës, 9 prej tyre janë fokusuar në çështje mjedisore, që përbën 13% të totalit të premtimeve. Programi përfshin premtime të gjelbra, por nuk ofron përllogaritje të sakta ose të përafërta të buxhetit për këto projekte të specifikuar në platformë. Sidoqoftë, vlera totale e investimeve në projekte mjedisore është 7.050.000.00€, sipas të dhënave të marra nga Komuna. Në lidhje me afatet kohore, komuna ka theksuar se projektet janë pjesë e platformës qeverisëse dhe do të përfundojnë deri në fund të mandatit por që në program zgjedhor nuk ka përcaktime të tilla kohore.

Sa i përket nivelit të zbatimit të premtimeve të gjelbra në Ferizaj del se shumica e tyre janë përmbushur, duke përfshirë vazhdimin e ndërtimit të kolektorëve të ujërave të zeza, gjelbërimin e kryqëzimeve në rrugët e qytetit, krijimin e parkingjeve për biçikleta, zgjerimin e hapësirave rekreative dhe përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave. Megjithatë, disa projekte, si rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe lobimi për tërheqjen e investitorëve, mbeten ende në proces ose në fazë fillestare, për të cilat nevojitet përkushtim i mëtejshëm.






Në total, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Ferizajt është si vijon:







## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Ferizajt



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:

Premtimi e gjelbra të Kryetarit Agim Aliu (FERIZAJ)		Të dhënat	Vlerësimi
1	Rregullimi i shtratit të lumit nga Ura e Dudit deri në fshatin Doganaj.	Për të parandaluar vërshimet dhe mbrojtur ekonomitë familjare, tokat dhe prodhimet bujqësore, Komuna e Ferizajt, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, në maj 2024 ka realizuar një projekt për pastrimin e mbi 20 kilometra të shtretërve të lumenjve në fshatrat Neredime, Balaj, Dremjak, Slivovë, Babush dhe Mirash.	 <b>I përmbushur</b>
2	Vazhdim i ndërtimit të kolektorëve të ujërave të zeza.	Komuna e Ferizajt në muajin mars 2023 ka nënshkruar katër kontrata për ndërhyrje, të cilat janë shtrirë në fshatrat Sazli, Dardani, Greme dhe Mirosal. Sipas informacioneve të komunës, këto ndërhyrje po vazhdojnë të realizohen bazuar në kërkesat e qytetarëve.	 <b>I përmbushur</b>
3	Gjelbërim i kryqëzimeve në rrugët e qytetit.	Për këtë zotim, vetëm për këtë fazë raportimi janë përfunduar miniparqet në Koshare (nëntor 2023), në fshatin Talinoc i Muhaxherëve (janar 2024), Tërrn dhe Gaçkë (maj 2024). Po ashtu, janë realizuar gjelbërimet në kryqëzimet e rrugëve, si rruga "Ahmet Kaçiku" (shkurt 2024) dhe rruga "Rexhep Bislimi" (prill 2024).	 <b>I përmbushur</b>
4	Parkingje për biçikleta.	Komuna e Ferizajt, nga qershori 2022 deri në vitin 2023, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, ka investuar në krijimin e parkingjeve të reja për biçikleta. Gjatë kësaj periudhe, janë rregulluar 6 vend parkingje në zonën urbane (qendër të qytetit).	 <b>I përmbushur</b>
5	Zgjerim i parkut në Koshare.	Ky projekt në nëntor 2023 ka përfunduar me zgjerimin e parkut.	 <b>I përmbushur</b>

Premtimi e gjelbra të Kryetarit Agim Aliu (FERIZAJ)		Të dhënat	Vlerësimi
6	Shtigje malore për ecje dhe biçikleta.	Në bashkëpunim me organizatën Swiss Contact, Komuna ka përcaktuar shtigjet malore të ecjes dhe lëvizjes me biçikleta në gjatësi prej 60 km. Kjo zonë gjithashtu është shenjëzuar në vitin 2022.	 <b>I përmbushur</b>
7	Dyfishimi i buxhetit për mirëmbajtje të parqeve.	Në Ferizaj, mirëmbajtja e parqeve realizohet nga kompani publike, si NPL "Ambienti" dhe KRM "Pastërtia", dhe një kompani private e kontraktuar. Gjatë viteve 2022-2023, ka pasur një rritje të dyfishtë të kostove për shërbime, ku një shërbim që kushtonte 0.25€ për njësi në 2022 tani kushton 0.50€. Në 2023 është iniciuar një kontratë trevjeçare prej 1.6 milionë euro me një operator privat, duke e çuar shumën totale për mirëmbajtjen e hapësirave publike mbi 3 milionë euro për tre vitet e ardhshme.	 <b>I përmbushur</b>
8	Lobimi për investitorë për trajtimin dhe riciklimin të mbeturinave.	Komuna ka zhvilluar bashkëpunim me kompani të huaja lidhur me trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave në shkurt 2023, siç janë kompanitë "Indaver" nga Belgjika dhe "Doosan GMBH" nga Gjermania dhe kompaninë Erdi Rproduct L.L.C në Kosovë, ku Komuna ka lëshuar lejen e ndërtimit për fabrikën për riciklimin e mbeturinave.	 <b>Gjysmë i përmbushur</b>
9	Ngritja e kapacitetit të kompanisë "Pastërtia".	Për nevojat e KRM "Pastërtia," janë blerë 3 kamionë për grumbullimin e mbeturinave me bashkëfinancim nga KRM "Pastërtia" dhe GIZ, me vlerë 100,000€, ndërsa procedura është udhëhequr nga KRM. Nga Gara për Mjedis të Pastër, janë përfituar 14 kamionë të tjerë (8 nga JAIKA Japoneze dhe 6 nga GIZ Gjerman). Aktualisht, KRM "Pastërtia" në Ferizaj disponon 7 kamionë. Po ashtu, Komuna e Ferizajt ka përfunduar ndërtimin e një objekti për KRM "Pastërtia," ku transferimi pritet të bëhet gjatë pjesës së parë të vitit 2025. Gjithashtu, janë shpërndarë 60 kontejnerë 1.1m <sup>3</sup> dhe 100 kontejnerë 120L, kryesisht për biznese, me investime të reja për vitin 2024.	 <b>I përmbushur</b>




# Komuna e Pejës



Programi elektorral i Komunës së Pejës, nën udhëheqjen e kryetarit Gazmend Muhaxheri, ka përfshirë një sërë premtimesh për zhvillimin e infrastrukturës, me fokus në përmirësimin e turizmit malor, menaxhimin e burimeve ujore dhe ujërave të zeza, si dhe krijimin e hapësirave të gjelbra rekreative. Iniciativat e prezantuara janë brenda kompetencave komunale, duke përfshirë investime në rrjetin rrugor, infrastrukturën ujore dhe mjedisore, me disa përparime tashmë të dukshme. Analiza e progresit tregon se disa prej këtyre projekteve kanë nevojë për një ritëm më të shpejtë të zbatimit dhe një angazhim më të madh në mënyrë që të arrihen rezultate konkrete dhe të prekshme për komunitetin.

Në Komunën e Pejës, kryetari aktual nuk ka pasur një program zgjedhor të shkruar. Kryetari gjatë fushatës elektorale kishte dhënë 25 premtime, nga të cilat 10 kanë qenë të fokusuar në çështje mjedisore, që përbën 40% të totalit të premtimeve zgjedhore. Sa i përket përllogaritjeve buxhetore, komuna ka bërë të ditur se janë ndarë fonde të dedikuara për projekte të gjelbra, me buxhetin e alokuar si vijon: 120,000 euro në vitin 2022, 230,000 euro në vitin 2023, 100,000 euro në vitin 2024 dhe 160,000 euro në vitin 2025.







**Në Komunën e Pejës, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra të bëra gjatë fushatës elektorale është si në vijim:**







## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Pejës



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Gazmend Muhaxheri (PEJA)	Të dhënat	Vlerësimi	
1	Asfaltimi i rrugës 12 km nga qyteti në drejtim të zonës së Rugovës me qellim të shfrytëzimit të Parkut Kombëtar.	Rruga Pejë-Rugovë është në kompetencë të Ministrisë, por komuna ka kryer riparimin e dhe shtrimin e segmenteve ku lidhen fshatrat. Rruga Peklenës është shtruar në një gjatësi prej rreth 10 km, dhe janë ndërtuar rrugë të reja në disa fshatra të Rugovës si asfaltimi i rrugës në fshatin Dugaivë me gjatësi prej 2.3 km. Kurse rindërtimi dhe sanimi i segmenteve të rrugës në Bogë dhe Shtupeq i Madh janë në proces ritenderimi.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
2	Shtirja e investimeve kapitale në fshatrat e Rugovës, veçmas me kanalizim dhe ujësjellës.	Janë alokuar 800,000 euro për ndërtimin e ujësjellësit në fshatrat Stankaj, Bogë dhe Shkrel. Deri më tani, në Stankaj janë ndërtuar dy rezervuarë dhe është përfunduar rrjeti i ujësjellësit në lagjen Lulaj. Megjithatë, në fshatrat Lutov, Pepaj dhe Malaj, ende nuk ka pasur progres në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
3	Instalimi dhe rregullimi i kanalizimit në lagjen "7 Shtatori".	Në muajin tetor 2024, në lagjen "Xhemajl Kada" ka përfunduar kanali atmosferik, infrastruktura rrugore dhe kanalizimi fekal, përkatësisht punimet kanë përfunduar në lagjen 7 Shtatori.	 <b>I përbushur</b>
4	Zhvillimi i katër qendrave të vogla të skijimit: në Bogë, Shkrel, Koshutan dhe Podi i Jakupit. Komuna e krijon infrastrukturën rrugore, energjetike dhe ujore në këto zona.	Nuk ka pasur progres për shkak të çështjeve me pronat private.	 <b>Nuk ka filluar</b>
5	Rregullimi i shtratit të Lumbardhit deri në fshatin Pepiq.	Janë realizuar punime në shtratin e lumit nga Patriarkana deri te Ura e Tranzitit, përfshirë ndërtimin e shtigjeve të ecjes dhe rregullimin e mureve mbrojtëse. Gjatë muajit tetor 2024, është pastruar lumi nga mbeturinat dhe janë vazhduar punimet për rregullimin e shtratit dhe mureve. Pjesa deri në fshatin Pepiq nuk ka përfunduar ende.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
6	Ndërtimi i parkut të shëndetit dhe ndërtimi i parkut të pishave në një sipërfaqe rreth 40 hektarë.	Projekti për ndërtimin e parkut të pishave është planifikuar për vitin 2025 dhe është përfshirë në hartën zonale.	 <b>I filluar</b>

Premtimet e gjelbra të Kryetarit Gazmend Muhaxheri (PEJA)	Të dhënat	Vlerësimi	
7	Krijimi i shëtitorës nga Patriarkana deri në fshatin Potraq në vlerë rreth 6 milionë euro	Deri në dhjetor 2024, janë realizuar punime për shëtitorën nga Patriarkana deri te Ura e Tranzitit, duke përfshirë ndërtimin e shtigjeve dhe mureve mbrojtëse. Vazhdimi i projektit është përfshirë në draft buxhet për fazat e ardhshme. Punimet në shëtitorën pranë Radio Kafes janë përfunduar.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
8	Finalizimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Kuqishtë.		 <b>Nuk ka filluar</b>
9	Hartimi dhe finalizimi i planeve rregulluese.	Harta Zonale për periudhën 2025–2031 është publikuar si e miratuar në janar 2024.	 <b>I përbushur</b>
10	Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Trestenik.	Nuk ka pasur progres.	 <b>Nuk ka filluar</b>

# Komuna e Rahovecit

Programi elektoral i paraqitur nga Smajl Latifi për Komunën e Rahovecit përfshin premtime në fushën e bujqësisë, energjisë së gjelbër, infrastrukturës ujore, mbrojtjes së mjedisit dhe krijimit të hapësirave rekreative. Inicativat kryesore përfshijnë zgjerimin e sistemit të ujitjes, trajtimin e ujërave të zeza, pastrimin e deponive ilegale, ndërtimin e shtigjeve dhe parqeve, si dhe investimet në energjinë e rinovueshme. Në tërësi, pjesa më e madhe e projekteve ka shënuar progres drejt zbatimit, ndërsa një pjesë e vogël mbetet ende në fazat fillestare.

Sa i përket programit zgjedhor për Komunën e Rahovecit kryetari ka pasur një të tillë të shkruar por i cili nuk gjendet si i qasshëm online. Aty, nga 84 premtime të dhëna gjatë fushatës, 22 kanë qenë të fokusuar në çështje mjedisore, që përbën 26.19% të totalit të premtimeve. Premtimet e gjelbra nuk kanë përlogaritje buxhetore të sakta ose të përafërta të përcaktuara në programin zgjedhor. Në aspektin e afateve kohore, programi nuk ka vendosur afate të sakta për realizimin e projekteve të gjelbra. Po ashtu, në këtë program nuk është shqyrtuar kapaciteti ekzistues njerëzor i komunës për realizimin e këtyre projekteve.

Në total, niveli i përmbushjes së premtimeve elektorale të gjelbra për Komunën e Rahovecit është si më poshtë:

Të filluara:



3 premtime



13.64%%

Gjysmë të përmbushura:



9 premtime



40.91%

Të përmbushura:



10 premtime



45.45%

## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Rahovecit



Të filluara:

13.64%%




Gjysmë të përmbushura:

40.91%













Të përmbushura:

45.45%















Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Smajl Latifi (RAHOVECI)	Të dhënat	Vlerësimi	
1	Efiçienca e energjisë në shkolla.	Projekte për efiçiençën e energjisë kanë përfunduar në disa shkolla, përfshirë Shkollën "Rilindja" në Çifllak, Shkollën "Faik Konica" në Celinë, Shkollën "Skender Kastrati" në Gexhë, Shkollën "12 Maji" në Ratkoc dhe Shkollën "Gëzim Hamza-Piktori" në Rahovec. Të gjitha kontratat që janë lidhur me Fondin e Kosovës për Efiçiençë të Energjisë.	 <b>I përbushur</b>
2	Rritja e sipërfaqeve/ plantacioneve me vreshta.	Sipërfaqja e mbjellë me vreshta është rritur nga 2322 hektarë në 2336 hektarë, një rritje prej 14 hektarësh. Investimi financiar në këtë sektor ka qenë 295,000 euro.	 <b>I përbushur</b>
3	Ndërtimi i një qendre të madhe magazinuese për ruajtjen e rrushit të të gjithë vreshtarëve rahovecas.	Ndërtimi i qendrës së madhe magazinuese për ruajtjen e rrushit është në proces, me investime nga komuna. Po ashtu, janë ndarë 60,000 euro shtesë nga granti i performancës për këtë qëllim.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
4	Subvencionimi i polisës së sigurimit për mbrojtjen e vreshtave nga fatkeqësitë natyrore.	Në vitin 2023, Programi për Pagesa Direkte përfshinte subvencionimin e sigurimeve, ku Ministria mbulonte 75% të kostos, Komuna e Rahovecit 15%, dhe fermerët 5%. Për vitin 2024, në Programin për Pagesa Direkte të Ministrisë, nuk është përfshirë mbulimi i sigurimit, por Komuna e Rahovecit ka vendosur që të mbulojë edhe 15% të vlerës së policës, sipas përgjigjes zyrtare nga komuna.	 <b>I përbushur</b>
5	Sponsorizimi i ligjit për ta shpallur Rahovecin zonë të veçantë bujqësore	Komuna e Rahovecit ka parashtruar kërkesa me shkrim në Ministrinë e Bujqësisë dhe Kuvendin e Kosovës për shpalljen e Rahovecit si zonë të veçantë bujqësore, por deri tani kërkesa nuk është përfshirë në agjendën legjislative.	 <b>I filluar</b>
6	Hapja e kanaleve të kullimit e të drenazimit, tek ato toka ku mblidhet uji si pasojë e të reshurave atmosferike	Puna për hapjen dhe rregullimin e kanaleve të kullimit është vazhduar në disa fshatra si Çifllak, Ratkoc, Celinë dhe Dri të Bardhë. Të gjitha këto projekte janë ende në proces.	 <b>I filluar</b>

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Smajl Latifi (RAHOVECI)	Të dhënat	Vlerësimi	
7	Zgjerim i sistemit të ujitjes për tokat bujqësore	Ka përfunduar faza e parë e projektit të financuar nga Banka Botërore, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe ShA "Dukagjinil". Pritet të fillojë faza e dytë e këtij projekti investiv në sistemin e ujitjes. Investimi në këtë fazë do të kapë vlerën gjithsej: 10 milionë euro, projekti është vazhdimësi e shumës 4.2 milionë euro, e filluar vite më parë. Projekti parashihet të zbatohet deri në vitin 2026.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
8	Rritja e sipërfaqes së serrave	Komuna ka përgatitur projekte falas për fermerët dhe ka ofruar mundësi për ndërtimin e serrave në sipërfaqe prej 84 ari më shumë. Po ashtu, është iniciuar procedura e prokurimit për ndërtimin e serrave të reja dhe çdo vit hapet thirrja për aplikim nga fermerët.	 <b>I përbushur</b>
9	Mbështetje e qendrave grumbulluese dhe përpunuese të pemëve dhe perimeve	Komuna e Rahovecit ka përkrahur pikën grumbulluese të pemëve dhe perimeve "Agro Celina", për furnizimin me fidanë dhe materiale të tjera për kultivimin e trangullit "Kurnishon". Me anë të këtij subvencionimi, "Agro Celina" ka pasur për obligim t'i kontraktojë fidanishtet që operojnë në komunën tonë, për t'i kultivuar fidanët e trangullit dhe këta fidanë t'u shpërndahen fermerëve pa pagesë me kushtin e vetëm që prodhimin ta dorëzojnë në qendrën grumbulluese "Agro Celina". Ky program është përkrahur në shumën prej 56.000 euro.	 <b>I përbushur</b>
10	Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe shndërrimi i këtyre hapësirave në gjelbërim	Komuna e Rahovecit ka vazhduar me pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave në Rahovec, në rrugën për Malishevë dhe Suharekë, ku janë mbjellur drunj dekorativ. Po ashtu janë pastruar deponitë ilegale në fshatrat: Krushë e Madhe, Gur i Kuq, në rrugën tranzit në Rahovec dhe në fshatin Brestoc kurse në Hoç të Madhe nga vëzhgimet e muajit dhjetor është vërejtur që deponia nuk është sanuar. Po ashtu, Komuna ka lidhur kontratë për eliminimin e deponive ilegale kudo që krijohen në vijimësi.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>



Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Smajl Latifi (RAHOVECI)		Të dhënat	Vlerësimi
11	Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura	Në bashkëpunim me Agjencinë Pyjore të Kosovës, komuna ka realizuar pyllëzimin e 17 hektarëve me 45,000 fidanë.	 <b>I përbushur</b>
12	Ndërtimi i parqeve të reja.	Përfundimi i ndërtimit të parqeve është në proces në disa fshatra të Rahovecit, përfshirë Çifllak, Pataqan i Epërm, Krushë e Madhe dhe Brestoc.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
13	Renovimi dhe fasadimi i objekteve të përbashkëta të banimit social.	Punimet kanë përfunduar në objektin e banimit social në qytetin e Rahovecit. Nuk ka informata për intervenime tjera në objekte të tilla.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
14	Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përrenjëve	Puna për rregullimin e shtretërve të lumenjve është në vazhdim e sipër në disa fshatra, përfshirë Celinë, Polluzhë, Malësi të Vogël dhe Brestoc.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
15	Trajtimi i ujërave atmosferike në qytet	Trajtimi i ujërave atmosferike në Rrugën "Gëzim Hamza" në qytet është përfunduar për segmentet e parë dhe të dytë, me një gjatësi totale prej 600 metrash. Gjithashtu, janë rregulluar pusetat dhe ujëmbledhësit në rrugët e mëposhtme në qytet: "Mulla Cufa," "Xhelal Hajda," "Selajdin Mullabazi," "Avdullah Bugari" dhe "Shejh Myhedini." Segmenti prej 300 metrash në Rrugën "Shejh Myhedini" është përfunduar gjithashtu (kjo rrugë do të trajtohet plotësisht me 780 metra kanal atmosferik), si dhe në Rrugën "Ali Sokoli" – 380 metra dhe në Rrugën "Fahredin Hoxha" – 95 metra. Puna do të vazhdojë me trajtimin e ujërave atmosferike edhe në Rrugën "Gëzim Hamza."	 <b>I përbushur</b>
16	Kolektorë dhe impiante për ujërat e zeza së bashku me qeverinë dhe donatorët	Kanë përfunduar disa segmente me kolektorë të ujërave të zeza në disa vendbanime, duke përfshirë Rahovecin me 4 segmente në rrugën "Vëllezërit Frashëri", tek objekti i banimit social, në rrugën kryesore në dalje për Xërxë dhe në Lagjen e Epërme, në Gexhë - 1 segment te Lagjja Himaj, në Ratkoc - 4 segmente mbi varrezat e fshatit, në rrugën "Martin Camaj", te përroi i fshatit dhe rruga "Valon Hoti" nën hekurudhë, në gjatësi prej 600 m, në Dobidol, ka përfunduar në tërësi rrjeti i kanalizimit, në fshatin Mrasor - 1 segment, Malësi e Vogël - 1 segment, në fshatin Dejnë - 1 segment, në gjatësi 1400 m, në Çifllak - 1 segment prej 700 m.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>


Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Smajl Latifi (RAHOVECI)		Të dhënat	Vlerësimi
17	Energjia e gjelbër do të praktikohet në vendosjen e paneleve diellore në objekte publike	Ka përfunduar projekti i vendosjes së paneleve solare në objektin e palestrës "Mizahir Isma" në Rahovec – donacion nga KFOR-i italian, 30.000 euro. Poashtu, ka filluar edhe projekti i vendosjes se fluturakeve të erës në bjeshkën e Zatriqit, që kap vlerën rreth 90 milionë euro.	 <b>I filluar</b>
18	Shtigje për biçiklistë	Janë ndërtuar shtigje të reja për biçiklistë në rrugën "Ibrahim Rugova", rruga tranzite e UÇK-së dhe rruga Rahovec-Hamoc-Fortesë.	 <b>I përbushur</b>
19	Fusha sportive në çdo fshat dhe lagje ku ekziston prona komunale	Fushat sportive janë përfunduar në fshatra të ndryshme si Malësi e Vogël, Dejnë, Gur të Kuq dhe në shkollën "Gëzim Hamza" në Rahovec.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
20	Hartimi i planeve të hollësishme rregulluese	Komuna ka miratuar planet zhvillimore dhe rregulluese për periudhën 2023-2032, duke përfshirë: Planin e Mobilitetit Urban, Planin e Transportit Rrugor Lokal, Planin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe të Rreziqeve të tjera për Komunën e Rahovecit.	 <b>I përbushur</b>
21	Shtirja e planifikimit hapësinor edhe në fshatra	Me miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, ka filluar edhe planifikimi hapësinor edhe nëpër fshatra, ku me anë të këtij plani janë caktuar zonat ndërtimore dhe zonat e caktuara për biznese.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
22	Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal	Plani Zhvillimor Komunal 2023-2032 është miratuar më 15 dhjetor 2023 dhe ka hyrë në fuqi.	 <b>I përbushur</b>

# Komuna e Gjakovës



Programi elektorale i Komunës së Gjakovës, i prezantuar nga Kryetari Ardian Gjini, bazohet në një seri premtimesh që përfshijnë ndërhyrje për ruajtjen dhe menaxhimin e mjedisit, përkatësisht ndërtimin e kanaleve të ujitjes, trajtimin e ujërave të ndotura, rregullimin e lumenjve dhe zbatimin e teknologjisë eficiente si ndriçimi publik LED. Gjatë vlerësimit të zbatimit të këtij programi, vërehet se, megjithëse disa projekte janë realizuar me sukses, të tjera janë ende në proces ose përballen me vonesa, duke theksuar nevojën për angazhim të mëtejshëm dhe monitorim më praktik. Ky program zgjedhor, megjithëse nuk është i publikuar online, përmban gjithsej 35 premtime të bëra gjatë fushatës, prej të cilave 9 janë fokusuar në çështje mjedisore, që përbëjnë 25.7% të totalit të premtimeve. Në programin zgjedhor, projektet e gjelbra nuk kanë të përcaktuara vlera financiare dhe nuk dihet një vlerë të saktë për të gjitha investimet e gjelbra, pasi Komuna e Gjakovës nuk ka dhënë informacion të plotë mbi shpenzimet totale të kryera deri më tani në këtë aspekt. Sa i përket afateve kohore, programi përmend afate për realizimin e projekteve, por jo për të gjitha iniciativat. Ndërkohë, programi nuk ofron poashtu një analizë të detajuar mbi kapacitetet njerëzore ekzistuese të komunës për implementimin e projekteve të gjelbra.

Në tërësi, realizimi i premtimeve elektorale të Kryetarit Gjini pasqyron një progres të përzier: shumica e projekteve kanë përfunduar implementimin ose janë gjysmë të përmbushura, ndërsa poashtu ka premtime që po zhvillohen me vonesa ose nuk kanë filluar fare.

Në total në komunën e Gjakovës, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra është si në vijim:



## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Gjakovës



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Ardian Gjini (GJAKOVË)	Të dhënat	Vlerësimi
1 Ndërtimi i kanaleve të ujitjes dhe pendave të ujit për fermerët/bujqit.	Nga viti 2022 deri në vitin 2024 janë realizuar ndërtimet e kanaleve të ujitjes në fshatrat si: Dobrigje, Dujakë, Palabardh, Planqor, Shqiponjë, Popoc, Dobrosh, Batushë, Molliq, Stubëll, Nivokaz, Babaj i Bokës, Dujakë, Rracaj dhe Bitesh-Palabardh. Gjithashtu, në kuadër të aktivitetit 'Auditimi Social' në muajin nëntor, kemi bërë vizitat në terren për të parë dhe vlerësuar nga afër punimet pas ndërtimit të kanaleve të ujitjes dhe pendave në fshatin Shishman dhe Shqiponjë.	 <b>I përbushur</b>
2 Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në zonën "Gjakova e Re" dhe në zonën "Rezina"	Ka përfunduar shtrirja e rrjetit të kanalizimit në segmentin e parë të lumit Llukac. Në dhjetor 2024, punimet janë në zhvillim e sipër në segmentin e dytë, ku po punohet për të përfunduar shtrirjen e kanalizimit. Ndërkohë, për segmentin e tretë të këtij projekti, po zhvillohen proceset administrative dhe përgatitjet për të filluar punimet në terren.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
3 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza.	Impianti për trajtimin e ujërave të zeza është përfunduar dhe tashmë është funksional, së bashku me dy kolektorët kryesorë. Gjithashtu, është realizuar rehabilitimi i kanaleve në 25 segmente dhe përfunduar zgjatja e kolektorit në veri të qytetit, në daljen për Pejë. Ky Impiant menaxhohet nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Gjakova" SH.A.	 <b>I përbushur</b>
4 Rregullimi i shtratit të lumit Llukac.	Rregullimi i shtratit të lumit Llukac ka përfunduar në segmentin e parë. Punimet në segmentin e dytë janë në fazën finale. Ndërkohë, për segmentin e tretë të këtij projekti, po zhvillohen proceset administrative dhe përgatitjet për të filluar punimet në terren.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
5 Sistemi i ndriçimit publik në qytet - i tëri do të zëvendësohet nga poçat e zakonshëm në sistemin LED	Gjatë vitit 2023, për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në territorin e Komunës së Gjakovës, janë investuar gjithsej 183,999.00 euro. Po ashtu, për kontratën e mirëmbajtjes së linjës së ndriçimit publik në Komunën e Gjakovës janë alokuar dhe shpenzuar gjithsej 144,998.00 euro. Në lidhje me kontratën e titulluar "Mirëmbajtja e ndriçimit publik," me numër të prokurimit 632-24-797-1-1-1, e lidhur më datë 16/04/2024 ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punimeve, më datë 25/10/2024, kjo kontratë është ndërprerë me marrëveshje të përbashkët midis palëve.  Pas këtij zhvillimi, më datë 14/11/2024, Kryetari i Komunës së Gjakovës ka marrë vendim për të caktuar zyrtarë mbështetës që do të monitorojnë marrëveshjen e re për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, e cila është lidhur ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe KRM Çabrat. Ky proces synon të sigurojë një menaxhim efektiv dhe një shërbim të qëndrueshëm për ndriçimin publik në të gjithë komunën.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Ardian Gjini (GJAKOVË)	Të dhënat	Vlerësimi
6 Për katër vite do të investohen 1 milion euro në krijimin e parqeve dhe terreneve sportive nëpër fshatra	Sipas Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës për vitin 2023, Çështja A3 ka evidentuar vonesa në përfundimin e punimeve të kontraktuara. Konkretisht, projekti për ndërtimin e terreneve të tenisit, me një vlerë prej 241,552 EUR dhe kontratë të nënshkruar më datë 01.09.2023, nuk është realizuar sipas planit dinamik të parashikuar prej 90 ditësh. Si rezultat, ka pasur një vonesë prej afërsisht dy muajsh në përfundimin e këtij projekti.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
7 Funkcionalizimi i kompanisë publike "Artitekti i qytetit"	Komuna e Gjakovës ka përfunduar të gjitha procedurat ligjore të nevojshme për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale "Arkitekti i Qytetit". Dokumentacioni i plotë dhe i kërkuar është dorëzuar tek Njësia për Menaxhimin e Ndërmarrjeve Publike, duke përbushur kështu të gjitha obligimet e parashikuara nga kuadri ligjor. Aktualisht, komuna ka njoftuar se është në pritje të vendimit nga Qeveria e Kosovës për finalizimin dhe themelimin zyrtar të kësaj ndërmarrjeje, e cila pritet të luajë një rol kyç në zhvillimin urbanistik dhe planifikimin strategjik të qytetit.	 <b>I filluar</b>
8 Hartimi i planit rregullues për pikën turistike "Maja e Kurorës". Në këtë zonë do të mbjellen arra, lajthi dhe gështenja	Deri në dhjetor 2024 nuk ka informacion në lidhje me iniciimin e hartimit të planit rregullues për pikën turistike "Maja e Kurorës".	 <b>Nuk ka filluar</b>
9 Miratimi i Planit Zhvillimor komunal dhe hartës zonale	Në muajin prill të vitit 2022 është miratuar Plani Zhvillimor Komunal, ndërsa në maj të vitit 2024 ka marrë miratimin edhe Harta Zonale.	 <b>I përbushur</b>

# Komuna e Lipjanit

Programi elektorale i Komunës së Lipjanit përfshin premtime të fokusuar në përmirësimin e mjedisit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin e hapësirave publike. Këto projekte, si hapja dhe mirëmbajtja e lumenjve, ndërtimi i parqeve, rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe mbjellja e drunjve dekorativ, adresojnë nevoja të prekshme për komunitetin, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetesës, reduktimin e përmytjeve dhe krijimin e hapësirave rekreative për qytetarët. Të gjitha këto projekte janë në përputhje me kompetencat e nivelit lokal.

Në Komunën e Lipjanit, kryetari ka pasur një program zgjedhor të shkruar gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2021, por ai nuk është i qasshëm në internet. Nga gjithsej 61 premtime elektorale të dhëna gjatë fushatës, 9 janë të fokusuar në çështje mjedisore, duke përbërë 14.75% të totalit të premtimeve. Programi zgjedhor nuk përfshin përllogaritje të sakta buxhetore për projektet e gjelbra. Megjithatë, bazuar në të dhënat e qasshme në buxhetet vjetore komunale, vlera e mjeteve të dedikuara për realizimin e projekteve të gjelbra deri tani arrin në 4,423,102.90 €. Ndërsa, buxheti total për projekte të gjelbra për këtë mandat është 5,499,076.30 €, që përfshin si projektet e realizuara, ashtu edhe ato që janë aktualisht në proces implementimi dhe pritet të përfundojnë gjatë vitit 2025. Në programin zgjedhor të kryetarit nuk janë përcaktuar afate kohore të sakta për realizimin e projekteve të gjelbra.

Në Komunën e Lipjanit, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra të bëra gjatë fushatës elektorale është si në vijim:

Të pafilluara:



1 premtim



11%

Gjysmë të përmbushura:



4 premtime



44.5%

Të përmbushura:




4 premtime









44.5%




## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Lipjanit



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:



Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Imri Ahmeti (LIPJAN)		Të dhënat	Vlerësimi
1	Hapja dhe mirëmbajtja e lumenjëve me qëllim të parandalimit të vërshimeve në tokat Bujqësore.	Në fillim të vitit 2022, kanë nisur disa procedura prokurimi për projektin "Mirëmbajtja e lumenjve në Komunën e Lipjanit". Një kontratë u miratua më 03.01.2022, por dokumentet e saj nuk janë bërë publike. Më 26.07.2023 u nënshkrua kontrata "Hapja-pastrimi i lumenjve dhe mirëmbajtja e hapësirave publike në fshatra", e vlefshme deri më 26.07.2025. Punimet nga kjo kontratë vazhdojnë.	 Gjysmë i përbushur
2	Ndërtimi i parqeve mbi hapësirën e parkingut nëntokësor.	Me datë 19.09.2023 është nënshkruar kontrata me titull "Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan". Sipas kontratës punët do të kryhen për 300 ditë pune, të ndara në tri vite fiskale, 2023-2024-2025, të ndara sipas mjeteve buxhetore, më së largu me datë 15.08.2025.	 Gjysmë i përbushur
3	Vazhdimi i punimeve në rregullimin e shtratit të lumit "Sitnica" (faza e II).	Në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është bërë rregullimi i shtratit të lumit "Sitnica" ("faza e II"). Punimet kanë filluar në pjesën e dytë të vitit 2022 dhe kanë përfunduar në gusht të vitit 2023.	 I përbushur
4	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale.	Në qytetin e Lipjanit janë lidhur disa kontrata të rëndësishme për mirëmbajtjen dhe pastrimin e infrastrukturës publike. Këto përfshijnë kontrata për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezoneve verore dhe dimërore, mirëmbajtjen e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave publike, pastrimin e varrezave dhe lapidarëve, si dhe hapjen dhe pastrimin e lumenjve.	 I përbushur
5	Themelimi i Ndërmarrjes Publike Komunale "Ulpiana" që do t'i ofrohet kompetencë për mbrojtja e mjedisit	Me datë 29.04.2021, Kuvendi Komunal i Lipjanit ka miratuar vendimin (Nr.prot.15-352-21925) për iniciimin e procedurave të themelimit të Ndërmarrjes Publike "Ulpiana". Vendimi me dokumentet përcjellëse është dërguar në ministri që në vitin 2021, mirëpo procedura nuk ka vazhduar më tej.	 Gjysmë i përbushur
6	Hapja dhe ndërtimi i parqeve të reja në zonat periferike të qytetit	Me datën 20.12.2022 është nënshkruar kontrata me titull: "Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkolla fillore, në fshatra: Kraishtë, Gllgovc, Rubofc, Bujan, Medvec, Topliqan, Krojmir, Baicë, Shalë, Magurë, Puturovc, Smallushë, Llugaxhi, Babush i Muhaxherëve, Banullë, Dobrajë e Madhe, Lipjan faza e II-të". Kjo kontratë ka përfunduar me datë 31.08.2023. Nga kjo kontratë kanë përfunduar punimet në ndërtimin e parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkolla fillore në fshatrat: Dobrajë e Madhe, Kraishtë, Rubovc, Banullë, Babush Muhaxherëve, Llugaxhi, Smallushë, Shalë, Krojmir, Topliqan, Baicë, Puturovc, Medvec, Magurë, Bujan, Gllgovc, Lipjan-faza II-të".  Me datë 15.07.2022 është nënshkruar kontratë me titull: "Ndërtim i këndeve të lojrave për fëmijë në Lipjan, Sllovi dhe Gadime". Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.	 I përbushur


Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Imri Ahmeti (LIPJAN)		Të dhënat	Vlerësimi
7	Mbjellja e drunjëve dekorativ në hapësirat publike të qytetit	Me datën 11.11.2022 është nënshkruar kontrata (Nr. Prokurimi 613-22-10506-5-2-1), me titull: "Rregullimi i hapësirave publike në Komunën e Lipjanit". Në kuadër të kësaj kontrate janë mbjellur 80 drunjë dekorativ. Me datën 05.10.2022 është nënshkruar kontrata me nr.613-22-8327-1-2-1/C672, me titull: "Furnizimi dhe mbjellja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit dhe rrugët lokale". Nga kjo kontratë janë mbjellur 500 drunjë dekorativ në hapësirat publike.  Me datë 11.08.2023 është nënshkruar kontratë (Nr. Prokurimi 613-23-4249-5-1-1/C808), me titull "Hapja dhe ndërtimi i rrugëve të reja brenda në qytetin e Lipjanit (Rr. Afrim Zhitia, Rr.Bashkim Krasniqi, Rr.Haradin Bajrami, Rr.Haxhi Kleqka), Llot 1. Në kuadër të kësaj kontrate janë mbjellur edhe 170 drunjë dekorativ.  Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Sipas një njoftimi të datës 16.11.2023, Komuna e Lipjanit ka marrë donacion 60 fidane nga Institucioni Mikrofinanciar Finca Kosovë, të cilat janë mbjellë në qytetin e Lipjanit.	 I përbushur
8	Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve në fshatra	Me datën 10.11.2022, është publikuar njoftimi mbi punimet në shtretërit e lumenjëve në Gadime të Epërme, Smallushë, Gllgovc dhe në lumin Janjevka. Me datë 08.09.2022 është nënshkruar kontrata, me titull: "Ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Smallushë". Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Me datë 17.08.2022 është nënshkruar kontrata me titull: "Rregullimi i shtratit të lumit Janjevka në lagjen e Konjuhut në Lipjan". Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Me date 16.08.2022 është nënshkruar kontrata me titull: "Ndërtimi i shtratit të lumit në Gllgovc". Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Me datë 18.07.2022 është nënshkruar kontratë me titull: "Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit në Gadime". Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Më 09.06.2023 është nënshkruar kontrata me titull: "Ndërtimi i shtratit të përrockave (lumejve) në qytetin e Lipjanit". Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Me datë 07.07.2023 është nënshkruar kontratë me titull "Ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Gadime dhe asfaltimi i rrugës rreth lumit". Kjo kontratë ka përfunduar me datë 15.10.2023. Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Me datë 07.07.2023 është nënshkruar kontratë me titull "Ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Smallushë, faza e dytë". Kjo kontratë ka përfunduar me datë 10.10.2023. Punimet nga kjo kontratë kanë përfunduar.  Mbesin ende fshatra me nevojë për një intervenim të tillë.	 Gjysmë i përbushur
9	Ndërtimi i sistemit të ujësjetësimit për fshatrat Vërshëc, Leletiq, Baicë dhe Akllap		 Nuk ka filluar

# Komuna e Skënderajt


Programi elektoral i Komunës së Skënderajt, i udhëhequr nga Fadil Nura, përfshin një sërë premtimesh të fokusuar në zhvillimin e infrastrukturës mjedisore, përmirësimin e shërbimeve publike dhe mbrojtjen e mjedisit. Iniciativat kryesore përfshijnë zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, ndërtimin e shtigjeve për ecje, përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe përmirësimin e transportit publik. Këto premtime qëndrojnë brenda kompetencave komunale dhe kanë shënuar përparime të dukshme. Në tërësi, pjesa më e madhe e projekteve janë përfunduar ose janë në faza të avancuara të zbatimit, ndërsa disa iniciativa ende mbeten në procesin përgatitor.

Nga gjithsej 66 premtime elektorale të dhëna gjatë fushatës, 8 janë të fokusuar në çështje mjedisore, duke përbërë 12.12% të totalit të premtimeve. Në programin zgjedhor të kryetarit nuk janë përcaktuar afate kohore të sakta për realizimin e projekteve të gjelbra kurse sa i përket buxhetit të dedikuar për projekte të gjelbra gjatë mandatit qeverisës, Komuna e Skënderajt nuk ka ofruar informacion.






Në Komunën e Skënderajt, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra të bëra gjatë fushatës elektorale është si në vijim:






## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Skënderajt



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Fadil Nura-Skenderaj	Të dhënat	Vlerësimi	
1	Shtirja e kanalizimit në fshatra	Është futur në buxhetin për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024. Me datën 07.09.2022 është lidhur kontrata 643-22-7688-5-1-1/325. me grupin e operatorëve ekonomik dhe tashmë punimet kanë përfunduar në bashkësitë lokale: Qirez, Klinë e epërme, Turiqec, Prekaz, Polac,Runik, Likoc, Rezallë.	 <b>I përbushur</b>
2	Angazhimi për realizimin e projektit për rritjen e kapacitetit të ujit të pijshëm në Shipol - Brus	Ky projekt është regjional, duke qenë se Skenderaj furnizohet me ujë nga Mitrovica, dhe hapi i vetëm që është bërë në këtë drejtim është takimet e kryetarëve me udhëheqësit e ujësjellësit rajonal në Mitrovicë.  Ndërsa me 02.12.2024 është nënshkruar kontratë e re për vazhdimin e kanalizimit në bashkësi lokale me numër 643-24-8804-5-1-1/c521.	 <b>I filluar</b>
3	Ndërtimi i shtigjeve për ecje në Çiçavicë, Radishevë, Tushilë dhe Kuçicë	Buxhetimi dhe kontraktimi i OE për këtë premtim i jep vlerësim i filluar.	 <b>I filluar</b>
4	Nisja e ndërtimit të pendës së ujit në Kuçicë	Me datën 31.07.2024 është bërë njoftimi për kontratë nga Ministria e Mjedisit dhe planifikimit hapësinor.  Me datën 06.11.2024 është bërë njoftim për dhënie të kontratës ndërsa me datën 18.11.2024 është bërë njoftim për nënshkrim të kontratës.  Është bërë edhe hartimi i projektit fillestar, ndërsa komuna ka krijuar kushtet hapësinore për investim në ndërtimin e kësaj dige.  Numri i kësaj kontrate është 2024/210-24-7597-2-1-1.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
5	Krijimi/ndërtimi i stacionit të autobusëve në qytet	Ky projekt është dhënë përmes shprehjes së interesit dhe i është dhënë një kompanie private me koncesion për 99 vite.  Stacioni tashmë është i përfunduar.	 <b>I përbushur</b>


Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Fadil Nura-Skenderaj	Të dhënat	Vlerësimi	
6	Renovimi dhe fasadimi i objekteve banesore afër sheshit dhe objekteve të viteve 60-ta dhe 70-ta	Projekti është realizuar përmes bonuseve ku kompanitë e kontraktuara për kryerjen e punëve të tjera e kanë pasur në marrëveshje që të bëjnë fasadimin e ndërtesave në kuadër të marrëveshjes filestare. Objektet në fjalë janë renovuar dhe fasaduar.	 <b>I përbushur</b>
7	Në gjashtë fshatrat e bashkësisë së Çirezit do të instalohen gypat e ujit	Me datën 19.06.2023 është nënshkruar kontrata me numër 643-23-2581-5-1-1 me operatorin ekonomik për shtritjen e rrjetit të kanalizimit në bashkësinë lokale Qirez dhe punimet kanë përfunduar në fundvit të vitit 2023.	 <b>I përbushur</b>
8	Rregullimi i shtigjeve për ecje, vrapim (i përseritur me premtimin 3)	Me datën 08.04.2024 është nënshkruar faza e dytë e kontratës për vazhdimin e punimeve, me datën 30.05.2024 është bërë njoftimi për dhënie të kontratës dhe me datën 07.06.2024 është bërë njoftimi për nënshkrim të kontratës me numër 643-24-3275-5-2-1.  Ndërsa nga situata në terren projekti është realizuar dhe shtigjet e ecjes janë funksionale.	 <b>I përbushur</b>

# Komuna e Podujevës


Programi elektorale i Komunës së Podujevës, nën udhëheqjen e kryetarit Shpejtim Bulliqi, përfshin premtime të orientuara drejt zhvillimit të bujqësisë, menaxhimit të burimeve natyrore dhe përmirësimit të infrastrukturës urbane (mobilitetit urban). Iniciativat kryesore përfshijnë ndërtimin e shtigjeve të biçikletave, zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemit të ujitjes për tokat bujqësore, si dhe mbjelljen e drunjve dhe pyllëzimin e zonave të gjelbra. Të gjitha këto premtime janë brenda kompetencave të qeverisjes lokale.

Në Komunën e Podujevës, kryetari ka pasur një program zgjedhor të shkruar, por ai nuk është i qasshëm online. Nga 61 premtime të dhëna gjatë fushatës, 8 kanë qenë të fokusuara në çështje mjedisore, që përbën 13.1% të totalit të premtimeve. Programi zgjedhor por nuk paraqet përlogaritje buxhetore të sakta ose të përafërta për këto projekte. Për sa i përket afateve kohore, nuk janë vendosur afate të sakta për realizimin e projekteve të gjelbra. Po ashtu, në kuadër të programit nuk shqyrtohet kapaciteti ekzistues njerëzor i komunës për realizimin e premtimeve ose projekteve të gjelbra.





Në Komunën e Podujevës, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra të bëra gjatë fushatës elektorale është si në vijim:



## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Podujevës



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:


Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Shpejtim Bulliqi (Podujevë)	Të dhënat	Vlerësimi	
1	Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore në luginën e Lumit Llap	Më 16.07.2024 është shpallur njoftimi për kontratë për Hartimin e projektit për sistemin e ujitjes së tokave bujqësore por në dhjetor 2024 është shpallur njoftimi për anulim, i përcjellur me njoftimin e ri. Ky premtim është në fazë prokurimi.	 <b>I filluar</b>
2	Pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore	Ky ka qenë proces i udhëhequr nga Agjencia e Pyjeve dhe në kuadër të kësaj Komuna e Podujevës ka participuar në këtë projekt.	 <b>I filluar</b>
3	Mbjellja e 20 mijë drunjëve në qytet	Komuna më 07.10.2024 ka nënshkruar kontratë për mbjelljen e 1150 drunjve dekorativë në zonën urbane.	 <b>I filluar</b>
4	Furnizimi me ujë të pijshëm për çdo fshat dhe lagje të qytetit	Investimet janë realizuar në zgjerimin e ujësjellsit në fshatin Herticë, Dumnicë dhe Orllan. Ndërsa projekti gjendet në fazën e fillimit të proceseve për rindërtim të sistemit të ujësjellsit në fshatin Sfeqel dhe Dumosh.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
5	Rregullim të qarkullimit brenda qytetit përmes planit të mobilitetit	Plani i mobilitetit për rregullimin e qarkullimit brenda qytetit është miratuar në shtator të vitit 2022 në bazë të të cilët po vazhdon të trajtohet kjo çështje.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
6	Ndërtimi i shtigjeve të biçikletave	Në rrugët të cilat po rikonstruktohen po ndërtohen shtigjet e biçikletave si: Rr. "Skenderbeu", rr. "Hakif Zejnullahu". Në proces është edhe rruga "Xhemail Mustafa" dhe "Zahir Pajaziti"	 <b>I përbushur</b>
7	Ndërtimi i stacionit të autobusëve	Stacioni i ri i autobusëve në Podujevë u përfundua më 19 qershor 2024	 <b>I përbushur</b>
8	Rregullimi i Parkut të Paqes	Në nëntor 2022 punimet që kishin filluar në gusht 2022 për rregullimin e parkut të paqes kanë përfunduar	 <b>I përbushur</b>

# Komuna e Kamenicës

Programi elektoral i Komunës së Kamenicës, i prezantuar nga Kryetari Kadri Rahimaj, përqendrohet në disa premtime të gjelbra që synojnë përmirësimin e kushteve mjedisore, menaxhimin e mbeturinave, transportin alternativ dhe menaxhimin e ujërave të zeza. Shumica e këtyre nismave hyjnë në kompetenca të qeverisjes lokale. Përfundim të projektit i stadiumit të atletikës, i cili financohet dhe menaxhohet kryesisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), e cila mban përgjegjësinë kryesore për zbatimin e tij. Gjatë vlerësimit të ecurisë së këtyre premtimeve, vërehet se disa projekte kanë arritur fazën të rëndësishme të zbatimit, ndërsa të tjera ende nuk kanë nisur ose përballen me vonesa.



Në Komunën e Kamenicës, kryetari aktual ka pasur një program zgjedhor të shkruar por i cili nuk është i qasshëm online. Nga 56 premtime të dhëna gjatë fushatës, vetëm 7 kanë qenë të fokusuar në çështje mjedisore, pra 12.5%. Për këto projekte nuk ka pasur një përlogaritje të saktë buxhetore, por bazuar në kontratat e realizuara dhe ato në proces, vlera totale e investimeve të gjelbra arrin në 4,384,986 euro. Përkundër këtyre investimeve, nuk janë vendosur afate të sakta për realizimin e projekteve, dhe në kuadër të programit nuk është shqyrtuar kapaciteti ekzistues njerëzor i komunës për zbatimin e tyre.

**Në total, niveli i përbushjes së premtimeve elektorale të gjelbra për Komunën e Kamenicës është si më poshtë:**





**Niveli i përbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Kamenicës**



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:


Premtimet e Gjelbra të Kryetarit KADRI RRAHIMAJ (KAMENICA)	Të dhënat	Vlerësimi
1 Hartimi i një plani për pyllëzim të zonave të zhveshura.		 <b>Nuk ka filluar</b>
2 Ndërtimi i shtegut për atletikë.	Më 27 nëntor 2024 është vënë gurëthemeli në Novosellë për stadiumin e parë të atletikës në Kosovë ku do të përfshihet një shteg ndihmës prej 100 metrash.	 <b>I filluar</b>
3 Caktimi i vendeve për deponi të ngurta.	Në shtator 2024 janë ndërtuar dy deponi për mbeturina të ngurta, një në fshatin Kolloleq e tjetra në fshatin Mocare.	 <b>I përbushur</b>
4 Krijimi i shtigjeve për biçikleta.	Shtigjet për biçikleta janë krijuar në brendi të qytetit të Kamenicës dhe në drejtim të Berivojcës. Faza e dytë mbetet për vitin 2025. Po ashtu, ka nisur ndërtimi i trotuarit së bashku me shtegun për biçikleta nga qyteti në drejtim të fshatit Ruboc.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
5 Krijimi i hapësirave të gjelbra.	Është përfunduar një park i gjelbër te sheshi i qytetit si dhe ka nisur rregullimi i një parku te Shtëpia e Kulturës. Poashtu, punët janë në fazën e finale për parkun në Luginën e Verdhë.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
6 Rregullimi i pritoreve për autobusë.	Në vitin 2023, është zhvilluar një proces tenderimi për ndërtimin e pritoreve në lokalitetet Hogosht, Shipashnicë e Poshtme, Hodonoc, Topanicë, Koretin dhe Kamenicë. Në këtë kuadër, më 25 tetor 2023 është mbajtur hapja e tenderëve për këtë projekt. Në vitin 2024 është shkëputur kontrata me operatorin për shkak të neglizhencës në kryerjen e punëve. Deri tani, është punuar vetëm në pritoret në qytet dhe në Topanicë.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>
7 Trajtimi i ujërave të zeza përmes sistemit të kolektorëve.	Projekti është përfunduar në Kopernicë dhe Karaçevë, ndërsa në Koretin ka mbetur i papërfunduar për një gjatësi prej 250 metrash të lumit. Megjithatë, punimet për përfundimin e këtij segmenti kanë rinisur në dhjetor 2024.	 <b>Gjysmë i përbushur</b>

# Komuna e Kaçanikut



Programi elektoral i Komunës së Kaçanikut, i prezantuar nga kryetari Besim Ilazi, ka përfshirë premtime për investime në ujitjen e tokave bujqësore, zgjerimin e rrjeteve të ujësjellësit në zona urbane e rurale, ndërtimin e kolektorëve për ujërat e zeza, përmirësimin e shtretërve të përroskave dhe menaxhimin e mbeturinave, si dhe rritjen e efikasitetit energjike. Vlen të theksohet se, megjithëse Komuna e Kaçanikut ka nisur disa projekte dhe disa i ka realizuar plotësisht, një numër shumë i madh iniciativash të premtuara ende nuk kanë marrë shtysën e duhur.

Në Komunën e Kaçanikut, kryetari ka pasur një program zgjedhor të shkruar, por ai nuk është i qasshëm në internet. Nga gjithsej 94 premtime elektorale të dhëna gjatë fushatës, 28 kanë qenë të fokusuar në çështje mjedisore, që përbën 30% të totalit të premtimeve. Programi zgjedhor përfshin premtime të gjelbra pa përllogaritje buxhetore për këto projekte. Megjithatë, bazuar në kalkulimet nga projektet e buxhetuara ndër vite, shuma totale e investimeve të dedikuara për projektet e gjelbra të premtuara gjatë fushatës është 1,298,550.89 euro. Jo të gjitha këto fonde janë shpenzuar, pasi shumë projekte janë ende në faza fillestare ose në proces implementimi siç mund të shihet në analizën e mëposhtme. Në aspektin e kapaciteteve njerëzore, projektet në programin e kryetarit janë ndarë sipas drejtorive përkatëse.










Në Komunën e Kaçanikut, niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra të bëra gjatë fushatës elektorale është si në vijim:






















## Niveli i përmbushjes së premtimeve të gjelbra në komunën e Kaçanikut



Më poshtë, mund të gjeni tabelën që tregon progresin e realizimit të këtyre premtimeve në kategori specifike të vlerësimit:

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Besim Ilazi (KAÇANIK)	Të dhënat	Vlerësimi	
1	Ndarja e 50,000 euro për rregullimin dhe krijimin e kanaleve të ujitjes për tokat bujqësore.	Komuna për vitin 2024 ka buxhetuar 50,000 euro për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatrat Biqec, Kovaqec dhe Dubravë.	 <b>I përmbushur</b>
2	Ndërtimi i stazës së çiklizmit Kaçanik – Hani Elezit, përgjatë lumit Lepenc.		 <b>Nuk ka filluar</b>
3	Ndërtimi i një fabrike për trajtimin e ujit të pijes në Sepetin-Dubravë.		 <b>Nuk ka filluar</b>
4	Shtimi i kapaciteteve dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në pjesët e larta të zonës urbane.	Në vitin 2023 është finalizuar kontrata për projektin e shtimit të kapaciteteve të ujit në Bajnicë dhe Kaçanik të Vjetër dhe rehabilitim i rrjetit në zonën urbane në Kaçanik. Në kuadër të projektit janë shtuar kapacitetet e ujësjellësit në zonat rurale. Ky projekt komunës i ka kushtuar 144,941.60 euro.	 <b>I përmbushur</b>
5	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Ivajë, pas marrjes së ndihmës nga Qeveria.	Në vitin 2023 është ndërtuar rrjeti primar i ujësjellësit në këtë fshat në gjatësi 6 km.	 <b>I përmbushur</b>
6	Futja në menaxhim e rrjeteve ekzistuese të ujësjellësit në fshatrat që nuk janë në menaxhim.	Në vitin 2023 komuna ka lidhur marrëveshje me kompaninë regjionale "Birfurkacioni" për menaxhimin e rrjetit të ujësjellësit në lokalitetet Dubravë-Doganaj-Elezaj-Nikaj-Rekë-Soponicë-Koxhaj dhe fshatin Stagovë. Mbesin ende disa fshatra në proces të kyçjes.	 <b>Gjysmë i përmbushur</b>
7	Ndërtimi i kolektorit për ujërat e zeza Gërlicë.	Ka hyrë si kod buxhetor me projektligjin 2025; Për vitin 2025 janë alokuar 50 000 Euro; Për vitin 2026 janë alokuar 100,000 Euro; Për vitin 2027 janë alokuar 147,500 Euro.	 <b>I filluar</b>
8	Shpallja në interes publik i lokacionit për ndërtim të impiantit për trajtim të ujërave të zeza.		 <b>Nuk ka filluar</b>
9	Ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimeve në fshatin Begracë.	Punimet janë në fazën finale për rrjetin e kanalizimit në Begracë.	 <b>Gjysmë i përmbushur</b>

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Besim Ilazi (KAÇANIK)	Të dhënat	Vlerësimi	
10	Hartimi i projektit të kolektorit për ujëra të zeza, Sllatinë - Guri Shpuar		 <b>Nuk ka filluar</b>
11	Ndërtimi shtratit të lumit Lepenc, segmenti Bob – Kovaqec		 <b>Nuk ka filluar</b>
12	Ndërtimi i shtratit të lumit Nerodime, segmenti Xhamia e Dëshmorëve – Runjevë	Projekti "Ndërtimi i shtratit të lumit Nerodime në Kaçanik" pritet të fillojë në janar 2025 dhe të përfundojë në dhjetor 2027. Sipas planit buxhetor, në vitin 2025 do të ndahen 300,000 euro, në vitin 2026 rreth 1,500,000 euro, ndërsa në vitin 2027 do të alokohen 2,200,000 euro, duke e çuar vlerën totale të projektit në 4,000,000 euro.	 <b>I filluar</b>
13	Ndërtim i shtretërve të përroskave	Komuna për 2025 ka paraparë investime për ndërtimin e shtretërve të përroskave. Procedurat e prokurimit pritet të fillojnë më vonë. Vlera e projektit është rreth 150,000.00 euro	 <b>Gjysmë i përmbushur</b>
14	Studimi i fizibilitetit të liqenit të Ivajës		 <b>Nuk ka filluar</b>
15	Hartimi i planit të ri komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2026	Është hartuar dhe miratuar në kuvend komunal Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027.	 <b>I përmbushur</b>
16	Krijimi i kompanisë komunale për menaxhim të mbeturinave, me ndihmën e Qeverisë së Kosovës		 <b>Nuk ka filluar</b>
17	Ngritja e kapaciteteve teknike të kompanisë për menaxhimin e mbeturinave.	MAPL-ja ka anuluar tenderimin e blerjes së automjetit të planifikuar me mjetet e Grantit të performancës komunale-Mjedisi i Pastër, në shumën 110,000.00 euro, (mjete të përfituara nga komuna e Kaçanikut), me arsyetimin se nuk është bartur kodi i këtij projekti nga viti 2023 në vitin 2024.	 <b>Gjysmë i përmbushur</b>
18	Mbulueshmëria prej 100% e territorit me shërbim të grumbullimit të mbeturinave.	Sipas të dhënave të raportuara nga komuna në AMMK (Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës) për vitin 2023 tregohet se mbulueshmëria e territorit me menaxhim të mbeturinave është 100%.	 <b>I përmbushur</b>

Premtimet e Gjelbra të Kryetarit Besim Ilazi (KAÇANIK)	Të dhënat	Vlerësimi
19	Faturimi i mbeturinave nga administrata komunale.	 Nuk ka filluar
20	Fillimi i ndarjes në burim të mbeturinave (kompostimi). Është duke u punuar në hartimin e Planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave (regjioni Ferizaj dhe Gjilan), ku parashihet të fillohet me implementimin e strategjisë 3R (reduktim, ripërdorim dhe riciklim) të mbeturinave.	 I filluar
21	Zbatimi i masave eficiente në rrjetet ekzistuese - vendosja e sistemit me panele diellore.	Të gjitha rrjetet e ndriçimit publik janë tashmë me drita eficiente LED, por panelet diellore akoma nuk janë vendosur.  Gjysmë i përbushur
22	Zbatimi i masave eficiente në objektet publike.	Është tenderuar projekti "Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të eficientës në SHMU "Nazmi Osmani" në vlerë prej 93,160.00 euro.  I filluar
23	Hartimi i planit të ri komunal për eficientë të energjisë 2022-2026.	 Nuk ka filluar
24	Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet, që do të vazhdojë deri në fasadimin e të gjitha objekteve.	Në mars 2023 është finalizuar faza e parë, ndërtimi i vrazhdë. Planifikohet që punët në tërësi të përfundojnë deri në fund të 2023.  Gjysmë i përbushur
25	Planifikimi dhe zgjidhja e problemeve të deponive ilegale si dhe caktimi i një deponie për mbetjet e ngurta	 Nuk ka filluar
26	Hartimi i hartës për mbrojtjen nga rreziqet natyrore	 Nuk ka filluar
27	Hartimi i hartës për rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve	 Nuk ka filluar
28	Hartimi i hartës për posedim/shfrytëzim të tokës	 Nuk ka filluar

# Agjenda e Gjelbër e Ballkanit Perëndimor dhe realiteti lokal

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e njohur edhe si Deklarata e Sofjes<sup>16</sup> është një iniciativë e rëndësishme që synon të përafrojë politikën e rajonit me objektivat e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane,<sup>17</sup> e cila shërben si strategji e re e rritjes së Bashkimit Evropian (BE) drejt ndërtimit të "një ekonomie moderne, neutrale ndaj klimës, efikase në përdorimin e burimeve dhe konkruuese."<sup>18</sup> Kjo agjendë synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm përmes pesë shtyllave kryesore: 1) dekarbonizimi, 2) ekonomia qarkulluese, 3) eliminimi i ndotjes, 4) bujqësia e qëndrueshme dhe 5) mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit.<sup>19</sup>

Sipas raportit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, Kosova ka shënuar disa hapa fillestar në këtë proces, sidomos në aspektin e kuadrit ligjor.<sup>20</sup> Konkretisht, janë hartuar dhe miratuar Ligji për Ndryshimet Klimatike<sup>21</sup> dhe Strategjia e Energjisë 2022-2031<sup>22</sup> të cilat përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt përafrimit me objektivat e Agjendës së Gjelbër. Gjithashtu, raporti i KDI-së për vitin 2023 evidenton progresin në këtë drejtim, duke përfshirë edhe Ligjin për Promovimin e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, por thekson se Kosova ende ndodhet në fazën fillestare të përbushjes së detyrimeve të kësaj agjende.<sup>23</sup>

Plani i Veprimit për Zbatimin e Agjendës së Gjelbër, thekson poashtu se Ballkani Perëndimor, përmes komunave ka një potencial të madh për të nxitur "zhvillimin e gjelbër"<sup>24</sup> dhe për të rritur ndërgjegjësimin mjedisor tek qytetarët, duke qenë se komunat në kuadër të kompetencave të tyre vetanake trajtojnë segmente të rëndësishme të ndërthurura në kuadër të pesë shtyllave të Agjendës së Gjelbër. Konkretisht, kompetencat e komunave në Kosovë, si

16 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, 2020, e qasshme në: <https://www.rcc.int/download/docs/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20EB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf>.

17 Marrëveshja e Gjelbër Evropiane është një strategji gjithëpërfshirëse e Bashkimit Evropian (BE), e prezantuar në dhjetor 2019, që synon ta bëjë Evropën kontinentin e parë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050.

18 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Deklarata e Sofjes mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, 2020, e qasshme në: <https://www.rcc.int/download/docs/Leaders%20Declaration%20on%20the%20Green%20Agenda%20for%20the%20EB.pdf/196c92cf0534f629d43c460079809b20.pdf>.

19 Ibid

20 RCC, Raporti i Zbatimit 2022 i Planit të Veprimit për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, e qasshme: [Regional Cooperation Council | Green Agenda for the Western Balkans Action Plan - Implementation Report 2022](https://www.rcc.int/download/docs/Regional%20Cooperation%20Council%20I%20Green%20Agenda%20for%20the%20Western%20Balkans%20Action%20Plan%20-%20Implementation%20Report%202022.pdf)

21 RKS: Ligji për ndryshime klimatike, e qasshme në: [2024\\_4be7add9-41cf-48b0-af67-faeab78cc8bc.pdf](https://www.rks.gov.net/legjislacion/legjislacioni/2024/4be7add9-41cf-48b0-af67-faeab78cc8bc.pdf)

22 RKS: Strategjia e Energjisë 2022 – 2031, e qasshme: [Strategjia e Energjisë 2022 – 2031, e qasshme: Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031.pdf](https://www.rks.gov.net/legjislacion/legjislacioni/2022/strategjia-e-energjise-e-republikes-se-kosoves-2022-2031.pdf)

23 KDI: KOSOVA NË PROCESIN E BERLINIT: Deri në çfarë mase janë përbushur angazhimet për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër, e qasshme: [Raporti i dytë i monitorimit: Kosova në Procesin e Berlinit: Deri në çfarë mase janë përbushur angazhimet për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër? - KDI](https://www.kdi.org/raporti-i-dyete-i-monitorimit-kosova-ne-procesin-e-berlinit-deri-ne-çfarë-mase-janë-përbushur-angazhimet-për-tregun-e-përbashkët-rajonal-dhe-agjendën-e-gjelbër-2-kdi).

24 Zhvillimi i gjelbër përkufizohet si një model ekonomik që synon të nxisë rritjen e qëndrueshme duke ruajtur ekosistemet natyrore, ulur ndikimin mjedisor dhe promovuar drejtësinë sociale. Ky model përfshin politikën dhe praktikën që mbështesin përdorimin efikas të burimeve natyrore, reduktimin e emetimit të karbonit dhe zhvillimin e teknologjive të pastra. Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), *Green Economy: A Briefing Paper*, 2011. E qasshme në: <https://www.unep.org>.

menaxhimi i mbeturinave, trajtimi i ujërave të zeza, transporti lokal miqësor me mjedisin (eco-friendly), digjitalizimi dhe zhvillimi i qyteteve të mençura (smart cities)<sup>25</sup> përputhen me objektivat e Agjendës së Gjelbër. Përveç këtyre, fusha të tjera si ngrohja lokale dhe eficientia e energjisë, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra dhe biodiversitetit, turizmi i qëndrueshëm dhe bujqësia ekologjike janë gjithashtu pjesë e masave që mund dhe duhet të zbatohen edhe në nivel komunal. Megjithatë, "komunat e Kosovës nuk janë të përfshira në ndonjë mekanizëm të strukturuar në nivel shtetëror për t'u koordinuar mbi detyrimet që dalin nga Agjenda e Gjelbër dhe që bien nën përgjegjësinë e tyre."<sup>26</sup>

Komuna e Prishtinës ka bërë disa hapa në zhvillimin e infrastrukturës për qytetet inteligjent, ndërsa Ministria e Ekonomisë dhe Komuna e Gjilanit kanë nënshkruar një marrëveshje për projektin "Pilotimi i konceptit të Smart City (Neutral Host)." Projekti "Smart City Kosova" është një projekt tjetër i cili synon bashkëpunimin mes pesë universiteteve nga vende të ndryshme për zhvillimin e një Strategjie Kombëtare për Zhvillim Urban të Zgjuar dhe të Qëndrueshëm. Ky projekt përfshin gjithashtu krijimin e strategjive specifike të qytetit inteligjent për shtatë qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjilan, Vushtrri dhe Lipjan.<sup>27</sup>

Institucionet qendrore dhe lokale shpesh dështojnë të përmbushin angazhimet e tyre publike, duke përfshirë ato që lidhen me projektet dhe iniciativat për mjedisin. Në periudhën 2021-2024, zbatimi i premtimeve elektorale për 38 komuna, ka arritur vetëm 42.13%<sup>28</sup> (përditësimi qershor 2024), kurse sipas analizës së KDI dhe organizatave partnere pjesë të Aleancës Qytetare për Transparencë - AQT në 11 komuna që janë subjekt i kësaj analize, fakti që vetëm 27.27% është zbatimi i plotë i premtimeve të gjelbra nga viti 2021 e deri në prag të vitit të fundit të këtij mandati (dhjetor 2024) tregon një shkallë tejet të ulët të zbatueshmërisë. Rrjedhimisht mbi 70% të premtimeve ose janë përmbushur pjesërisht, ose nuk kanë filluar. Kjo gjendje tregon nevojën urgjente për përforcimin e qasjes më të përgjegjshme të komunave karshi premtimeve të tyre, e në veçanti premtimeve të gjelbra që do të duhej ti kontribuonin politikave më të qëndrueshme dhe të përgjegjshme në zbatimin e Agjendës së Gjelbër.

Promovimi i projekteve të gjelbra, ndonëse gjatë fushatës zgjedhore është parë si strategji e nevojshme dhe tërheqëse nga kandidatët për kryetarë të komunave dhe subjektet politike, në praktikë të qeverisjes lokale nuk u arrit të materializohet në shkallën e duhur. Niveli i pamjaftueshmëri i njohurive për fushën, sidomos për obligimet që kishte marrë Kosova dhe institucionet e saj me nënshkrimin e Agjendës së Gjelbër, dhe kompleksiteti i realizimit të këtyre projekteve si pasojë e mungesës së analizave të duhura, kapaciteteve njerëzore e financiare kanë bërë që komunat të ngecin prapa me zbatimin e tyre.

Përkundër zotimeve të Kosovës për të përafuar politikat dhe projektet kombëtare me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së (Green Deal), Marrëveshjen dhe Planin e Veprimit për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, zbatimi i tyre ka qenë i mangët dhe i ngadaltë, shpesh edhe për mungesën e një qasje multisektoriale, ndër-institucionale dhe një koordinimi të strukturuar midis institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal. Gjithashtu, "ka mungesë të theksuar të kapaciteteve institucionale për të realizuar këto angazhime në mënyrë efektive.

25 *Plani i Veprimit për zbatimin e deklaratës së Sofjes për agjendën e gjelbër për Ballkanin Perëndimor 2021-2030*, e qasshme: [Regional Cooperation Council | Action Plan for the Implementation of the Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans 2021-2030](#)

26 *Intervistë me Lorena Sekiraga, Eksperte për Çështje Rajonale në Kabinetin e Kryeministrit, RKS, më 12 shkurt 2025, e cila theksoi: "Aktualisht, nuk ka një mekanizëm formal të koordinimit mes nivelit qendror dhe komunal për Agjendën e Gjelbër. Komunikimi ka qenë kryesisht përmes pikave të kontaktit për secilin shtyllë të agjendës. Sfidat e njëjta janë të pranishme edhe në rajon e që pritet të adresohen gjatë vitit 2025."*

27 *KDI: KOSOVA NË PROCESIN E BERLINIT: Deri në çfarë mase janë përmbushur angazhimet për Tregun e Përbashkët Rajonal dhe Agjendën e Gjelbër*, e qasshme: [KDI Raporti-i-dyte-i-monitorimit\\_Kosova-ne-Procesin-e-Berliniit.pdf](#)

28 Instituti GAP, Letërnjoftimi i Komunave. e qasshme: <https://www.institutigap.org/lajme/2808>

Për çfarë qeveria në takimet rajonale ka kërkuar asistencë për rritje dhe forcim të kapaciteteve institucionale në zbatim të kësaj Agjende."<sup>29</sup>

Një strukturë më e qartë e bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal do të ndihmonte në një zbatim më efikas të politikave të qëndrueshmërisë, duke siguruar që komunat të kenë mbështetjen dhe burimet e nevojshme për të përmbushur objektivat e Agjendës së Gjelbër.

## Sa janë të informuara komunat me Agjendën e Gjelbër?

Përmbushja e premtimeve të gjelbra elektorale është thelbësisht e lidhur me angazhimet e përgjithshme për tranzicionin e gjelbër dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Shumë nga premtimet e dhëna nga kryetarët e komunave gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021 nuk duhet parë vetëm si projekte lokale, por si pjesë e synimeve më gjithëpërfshirëse të vendit për të kontribuar në tranzicionin e gjelbër të vendit dhe rajonit, që kërkon reforma të thella në sektorët e energjisë, ekonomisë qarkore, ndotjes, biodiversitetit dhe bujqësisë së qëndrueshme.

Në Kosovë, ndërsa përgjegjësia kryesore për hartimin e politikave dhe reformave të gjelbra qëndron në nivelin qendror, Plani i Veprimit i Agjendës së Gjelbër përcakton qartë se një pjesë e madhe e përgjegjësisë për zbatimin e saj bie mbi komunat. Autoritetet lokale luajnë një rol të rëndësishëm në shndërrimin e angazhimeve të gjelbra në veprime konkrete, duke përfshirë projekte për eliminimin e ndotjes, promovimin e transportit publik, menaxhimin e mbeturinave, ruajtjen e biodiversitetit, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe shumë të tjera.

Analiza e zbatimit të premtimeve të gjelbra nga komunat shpërfaq një element shumë të rëndësishëm - atë të mungesës së informimit të komunave për këtë agjendë dhe për këto obligime. Për t'u thelluar edhe më tej në shkaqet, KDI realizoi një pyetësor me 11 komuna përmes të cilit u synua të kuptohet me shumë për nivelin e informimit, përfshirjes, kapaciteteve dhe sfidave që autoritetet lokale hasin me këtë proces. Komunat janë pyetur nëse janë të familjarizuara me dokumentet kyçe të Agjendës së Gjelbër, ku e kanë marrë informacionin ose dokumentet, a bashkërendohen dhe a kanë një kanal të qartë komunikimi me institucionet e nivelit qendror ose ndërmjet vete, si dhe nëse kanë marrë pjesë në takime informuese apo punëtori për këtë çështje.

Nga rezultatet e pyetësorit, të gjithë zyrtarët komunalë deklaruan se kanë dëgjuar për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Ndër burimet kryesore të informimit renditen rrjetet sociale, dokumentet zyrtare të Bashkimit Evropian, trajnimet e organizuara nga OJQ-të dhe donatorët, si dhe media tradicionale. Sipas rezultateve, 73% e zyrtarëve komunalë e kanë lexuar dokumentin bazë të Agjendës së Gjelbër, ndërsa 27% nuk e kanë konsultuar ende atë. Në lidhje me Planin e Veprimit, 82% e zyrtarëve deklaruan se janë të informuar, ndërsa 18% jo. Këto të dhëna tregojnë një nivel të kënaqshëm të informimit, por gjithashtu sugjerojnë hapësirë për përmirësim në qasjen ndaj informacionit të detajuar dhe materialeve përcjellëse të Agjendës. Kjo tregon nevojën për iniciativë më të strukturuar që do të ndihmonin në thellimin e njohurive dhe zbatimin më efikas të angazhimeve të gjelbra në nivel lokal.

29 *Intervistë me Lorena Sekiraga, Eksperte për Çështje Rajonale në Kabinetin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, më 12 shkurt 2025, e cila theksoi: "Një nga sfidat kryesore është se plani i veprimit për zbatimin e Agjendës së Gjelbër është tepër i përgjithshëm dhe ka nevojë të specifikohet më tej për secilin shtet - kjo është përshtypja e përgjithshme në të gjithë rajonin. Gjithashtu, rajoni aktualisht nuk disponon kapacitetet e nevojshme për zbatimin efektiv të këtij plani. Për këtë arsye, gjithmonë është përmendur sfida e mungesës së kapaciteteve institucionale dhe financiare për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda e Gjelbër, si dhe nevoja për mbështetje të mëtejshme. Pritet që këto çështje të adresohen edhe nga vetë Këshilli për Bashkëpunim Rajonal gjatë vitit 2025."*



Sa i përket pjesëmarrjes së zyrtarëve komunalë në takime që kanë trajtuar Agjendën e Gjellbër apo zbatimin e saj, 82% kanë marrë pjesë në të paktën një takim, punëtori ose diskutim publik mbi këtë çështje gjatë tre viteve të fundit. Këto aktivitete janë organizuar kryesisht nga OJQ-të, donatorët dhe institucionet publike qendrore. Në anën tjetër, vetëm 55% e zyrtarëve deklarojnë se janë në dijeni të ndonjë mekanizmi koordinues ndërinstytucional, por shumica e përgjigjeve të tyre tregojnë një mungesë të qartësisë ose njohurisë së saktë mbi to.

Iniciativat lokale përfshijnë pesë shtylla kryesore: Dekarbonizimin (izolim ndërtesash, energji diellore, kurse energjie), Ekonominë qarkore (riciklimi i mbeturinave), Eliminimin e ndotjes (pastrimi i lumenjve, transport publik, monitorim ajror), Bujqësinë e qëndrueshme (mbështetje për fermerët, praktika organike) dhe Mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit (restaurim pyjesh, mbjellje e llojeve vendase, hapësira të gjelbra). Megjithatë, financimi mbetet i varur kryesisht nga donatorët, ndërsa një pjesë e projekteve mbështeten nga komunat, qeveria dhe fondet speciale si Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.

Një nga sfidat kryesore është mungesa e një mekanizmi të rregullt për raportimin e progresit të projekteve të gjelbra. Edhe pse këto projekte kontribuojnë drejtpërdrejt në Agjendën e Gjellbër dhe janë parashikuar në planin e veprimit, mbetet e paqartë nëse komunat raportojnë në mënyrë të strukturuar tek Qeveria, duke krijuar boshllëqe në monitorim dhe vlerësim. Vetëm 27% e zyrtarëve deklarojnë se kanë një praktikë zyrtare raportimi, por në përgjigjet e tyre del se ky raportim nuk ndodh tek qeveria qendrore por te institucione tjera të cilat financojnë projekte që ndërlidhen me përmbushjen e Agjendës së Gjellbër, ndërkohë që 64% nuk janë të sigurt nëse ekziston një mekanizëm i tillë, dhe 9% konfirmojnë se komuna e tyre nuk ka në dispozicion një mekanizëm raportimi tek Qeveria qendrore. Kjo mungesë e qartësisë pengon krijimin e një pasqyre kombëtare mbi progresin e Agjendës së Gjellbër, duke vështirësuar krahasimin e arritjeve dhe sfidave mes komunave.

Në përgjithësi, niveli i lartë i përfshirjes së komunave (82% në takime mbi Agjendën dhe 100% në zbatim projektsh të gjelbra) tregon një angazhim të konsiderueshëm në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore. Megjithatë, fakti që disa komuna zbatojnë projekte të gjelbra pa qenë të vetëdijshme për lidhjen e tyre me Agjendën e Gjellbër sugjeron nevojën për një koordinim dhe informim më të mirë mbi kornizën strategjike dhe objektivat afatgjata të kësaj agjende. Poashtu, 27% e zyrtarëve del se nuk e kanë lexuar ende dokumentin bazë të Agjendës, ndërsa 45% mbeten të painformuar mbi mekanizmat koordinues, duke reflektuar nevojën për një komunikim më efektiv dhe qasje më të strukturuar në shpërndarjen e informacionit. Vetëm 27% e komunave kanë një praktikë të rregullt raportimi, ndërsa 64% nuk e dinë nëse ekziston një mekanizëm i tillë dhe 9% konfirmojnë mungesën e tij. Kjo tregon nevojën për një strukturë të unifikuar raportimi, e cila do të ndihmonte në monitorimin më të mirë të progresit.

# REKOMANDIME

## Për kryetarët e Komunave:

- Kryetarët e komunave duhet të sigurojnë resurse njerëzore dhe financiare për të zbatuar projektet e gjelbra të premtuara gjatë fushatës.
- Projektet mjedisore duhet të bazohen në planet zhvillimore komunale, projeksionet buxhetore, legjislationin e vetëqeverisjes lokale si dhe të harmonizohen me politikën nacionale ambientale, përfshirë këtu objektivat afatgjata dhe planin e veprimit të prodhuar nga marrëveshja rajonale për Agjendën e Gjellbër.
- Komunat duhet të krijojnë mekanizma të raportimit periodik për qytetarët për ecurinë e projekteve të premtuara, përfshirë progresin dhe sfidat.
- Komunat duhet të planifikojnë buxhet dhe resurse për mirëmbajtjen afatgjate të projekteve të gjelbra duke siguruar qëndrueshmërinë e tyre.
- Kryetarët e komunave dhe vetë komunat duhet të intensifikojnë bashkëpunimin regjional në çështjet që dalin nga obligimet e tyre për menaxhim të mbeturinave, menaxhim të ujërave të zeza apo burimeve ujore.
- Të inkurajohet shkëmbimi i praktikave të mira mes komunave që kanë pasur sukses në projekte të gjelbra.
- Komunat duhet të ndërtojnë politika për edukim mjedisor dhe të zbatojnë politika që sanksionojnë ndotësit e ambientit.
- Ofrimi i uljeve të taksave ose lehtësirave për ndërmarrjet që aplikojnë praktika miqësore me mjedisin, si energjia e rinovueshme apo menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve.
- Mbështetje për fermerët që aplikojnë praktika bujqësore ekologjike, si agro-pylltaria apo përdorimi i teknikave të kursimit të ujit.
- Komunat të krijojnë qendra komunitare për riciklim.

## Për institucionet qendrore:

- Qeveria duhet të krijojë një mekanizëm komunikimi, monitorimi dhe raportimi me komunat për të siguruar integrimin dhe zbatimin e Agjendës së Gjellbër në të gjitha nivelet e qeverisjes.
- Qeveria duhet të shtojë angazhimin e aktorëve relevantë në hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore në përputhje me obligimet e marra si shtet në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

- Qeveria taksën mjedisore duhet ta kthejë në investime mjedisore.
- Qeveria, në bashkëpunim me komunat, duhet të nxisë trajtimin e mbetjeve të riciklueshme dhe të investojë në infrastrukturën e nevojshme për trajtimin e tyre.
- Qeveria duhet të promovojë transportin e qëndrueshëm përmes subvencioneve për transportin publik ekologjik ndërurban.

#### **Për qytetarët:**

- Qytetarët duhet të monitorojnë dhe kërkojnë llogari nga kryetarët e komunave për premtimet e tyre mjedisore.
- Qytetarët duhet të angazhohen në konsultime publike, dëgjime buxhetore dhe iniciativa qytetare për të ndikuar në politikat që prekin mjedisin dhe cilësinë e jetës së tyre.
- Qytetarët duhet të raportojnë degradimet e mjedisit përmes formave të ndryshme, ndër to duke përdorur edhe platformën [kdi-green.org](http://kdi-green.org).
- Qytetarët mund të kontribuojnë duke marrë pjesë në organizime vullnetare për të kontribuar në mbrojtje të mjedisit.

#### **Për subjektet politike:**

- Programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të komunave dhe subjekteve politike, me theks projektet që lidhen me qeverisjen e gjelbër, duhet të jenë mirë të specifikuara, të matshme dhe të ofrojnë detaje mbi planin e realizimit teknik, fizibilitetin dhe koston financiare, afatet kohore, lokacionet, efektin që do të prodhojnë këto projekte e mbi të gjitha të demonstrojnë bazueshmërinë në nevojat e komunitetit.
- Premtimet elektorale duhet të bazohen në kompetenca të vetëqeverisjes lokale për të garantuar zbatueshmëri dhe llogaridhënie.
- Programet zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të komunave dhe subjekteve politike duhet të reflektojnë objektivat e Agjendës së Gjelbër, përkatësisht detyrimet që Kosova ka marrë në kuadër të kësaj marrëveshjeje, me theks të veçantë ato që bien nën përgjegjësinë e komunave.
- Subjektet politike dhe kandidatët për kryetarë duhet të punojnë me qytetarët për t'i informuar për detajet e programeve zgjedhore, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien.

Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT):



Public Organization  
for Local Initiatives and Supports  
POLIS



FORTESA



INICIATIVA QYTETARE SKENDERAJ  
SKENDERAJ CIVIC INITIATIVE



CENTER POLICIES ADVOCACY  
QENDRA POLITIKA AVOKIM



RRJETI I OJQ-VE TË GRAYT QELIZA  
NGO WOMEN NETWORK QELIZA



Center for  
Peace and Tolerance



Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT) është themeluar në vitin 2020 dhe ka për synim të avokoj dhe lloboj tek institucionet lokale dhe qendrore në rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien institucionale. Anëtarët e AQT janë: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, OJQ IQS, OJQ SHIP, OJQ FOJK si dhe KDI. AQT gjatë vitit 2021 është plotësuar edhe Mundësia NGO, 2. Polis, 3. AvoNet, 4. Qeliza, 5. Gjethi, 6. Center for Peace and Tolerance, 7. Center for Policies and Advocacy (QPA), 8. OJQ SHL Kosova, 9. Iniciativa Qytetare Skenderaj (IQS), 10. Ekovizioni, 11. NGO Fortesa, 12. Syri i Vizionit.

Ky raport është mundësuar me përkrahjen financiare të:

UNDEF  
The United Nations  
Democracy Fund



FNUD  
Fonds des Nations Unies  
pour la démocratie